

1 E premte, 4 shkurt 2022

2 [Konferencë mbi Ecurinë e Çështjes]

3 [Seancë e hapur]

4 [Të akuzuarit marrin pjesë përmes videolidhjes]

5 --- Seanca fillon në orën 14.30

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Mirëdita të gjithëve. Mirë  
7 se keni ardhur.

8 Zonja Sekretare, ju lutem paraqitni lëndën.

9 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Mirëdita, i nderuar  
10 Gjykatës. Kjo është lënda me numër KSC-BC-2020-06, Prokurori i  
11 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep  
12 Selimit dhe Jakup Krasniqit.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zonja  
14 Sekretare.

15 Tani, u lutem palëve dhe pjesëmarrësve që të prezantohen,  
16 duke filluar me Zyrën e Prokurorit të Specializuar.

17 Zonja Prokurore, keni fjalën.

18 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Mirëdita, i nderuar Gjykatës.  
19 Përshëndes dhe ata që na ndjekin brenda sallës dhe jashtë  
20 sallës. Për Zyrën e Prokurorit të Specializuar sot ndodhet  
21 Alan Tieger, Prokuror i Lartë; Ward Ferdinandusse, Shef i  
22 Hetimeve në Prokurori; Maerlene Yahya Haage, Nëpunëse e  
23 Çështjeve Ligjore dhe për Nxjerrjet; dhe po kështu kemi edhe  
24 stazhieren Mia Vukoviç dhe Van Glungem [fonetikisht]. Dhe unë  
25 jam Clare Lawson, Prokurore e Lartë.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Mirë.

2 Ja japim fjalën Mbrojtjes.

3 Z. KEHOE: [Përkthim] Mirëdita. Jam Gregory Kehoe  
4 paraqitem në emër të zotit Hashim Thaçi, bashkë me mua këtu  
5 ndodhet Pierre Prosper, Sophie Menegon, Dasdit Pallaska dhe po  
6 kështu zotëria i pashëm me mjekër është Jonathan Greenblatt.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zoti Kehoe.

8 Ja jap fjalën zoti Emerson.

9 Z. EMMERSON: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Mirëdita,  
10 të gjithëve, i nderuar Gjykatës dhe të tjerëve që janë të  
11 pranishëm në sallë dhe jashtë sallës. Paraqitem sot në emër të  
12 zotit Veseli, asistohem brenda në sallë nga zoti Andrew  
13 Strong, Bashkëmbrojtës; zonja Annie O'Reilly, Mbrojtëse; zoti  
14 Kujtim Kerveshi, Mbrojtës; dhe nga zonja Pascale Langais,  
15 Oficere Gjyqësore. Po kështu, sot, na bashkohet dhe zoti  
16 Hajredin Kuçi.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

18 Zoti Young.

19 Z. YOUNG: [Përkthim] Përshëndetje. Sot kam zotin Geoffrey  
20 Roberts, doktoreshë Rudina Jasini dhe zonjushë Furtuna  
21 Sheremeti. Faleminderit.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zoti Young.

23 Zonja Alagenda, kush është i pranishëm.

24 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar  
25 Gjykatës. Mirëdita. Më quajnë Venkateswri Alagenda paraqitem

1 për zotin Krasniqi, së bashku me zotin Aidan Ellis, Mbrojtës;  
2 zotin Viktor Baiesu, Mbrojtës; dhe kemi dhe ndihmësin juridik,  
3 zotin Mentor Beqiri.

4 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

5 Po kështu vërej se Zoti Thaçi, zoti Selimi, zoti Krasniqi  
6 nuk janë fizikisht të pranishëm në sallë, por e ndjekin këtë  
7 përmes videokonferencës.

8 I kthehem tani Mbrojtësit të Viktimave, zotit Laws.

9 Z. LAWS: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Mirëdita. Jam  
10 Mbrojtësi i Viktimave, më quajnë Simon Laws.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

12 Nga Zyra Administrative, zoti Nilsson.

13 Z. NILSSON: [Përkthim] Mirëdita, i nderuar Gjykatës. Jam  
14 Jonas Nilsson nga Divizioni për Shërbime Gjyqësore pranë Zyrës  
15 Administrative.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zoti Nilsson.

17 Për procesverbal unë jam Nicolas Guillou, Gjykatës i  
18 Procedurës Paraprake për këtë çështje gjyqësore.

19 Më datë 22 janar 2022 caktova datën e konferencës së  
20 dhjetë për ecurinë e çështjes. Dhe u kërkova palëve që të  
21 bënin parashtrime me shkrim nëse dëshironin.

22 Më 1 shkurt 2022, ZPS-ja dhe tre ekipe të Mbrojtjes dhe  
23 Zyra Administrative dorëzuan parashtrimet e tyre me shkrim.

24 I falënderoj palët për këtë.

25 Qëllimi i seancës sot është që të shqyrtojmë ecurinë e

1 kësaj çështje gjyqësore dhe të diskutojmë për këto tema të  
2 rendit të ditës; konkretisht nxjerrje e materialeve,  
3 përkthimet, hetimet e ZPS-së dhe hetimet e Mbrojtjes. U kërkoj  
4 palëve, si zakonisht, që t'i paraqesin pikëpamjet e tyre në  
5 mënyrë koncize për secilën pikë të rendit të ditës.

6 Përpara se të kalojmë me çështjet që kanë të bëjmë me  
7 nxjerrjen, dëshiroj që të trajtoj kërkesën e Mbrojtjes së  
8 Thaçit për t'u dëgjuar në seancë për çështje që kanë të bëjnë  
9 me rishikimin e paraburgimit dhe me parashtrimet e ZPS-së  
10 lidhur me trajtimin e informacioneve konfidenciale dhe  
11 kontaktet e palëve me dëshmitarët.

12 Sa i takon rishikimit të paraburgimit, e ftojme Mbrojtjen  
13 e Thaçit që ta bëjë këtë kërkesë në kuadër të rishikimit të  
14 ardhshëm të paraburgimit. Sa i takon parashtrimeve të ZPS-së  
15 që kanë të bëjnë me trajtimin e informacioneve konfidenciale  
16 dhe kontaktet e palëve me dëshmitarët, i kërkoja Zyrës  
17 Administrative të bënte parashtrime, të cilat janë  
18 protokolluar dhe janë shpërndarë sot në mëngjes.

19 U kam kërkuar palëve që t'u kundërpërgjigjen këtyre  
20 parashtrimeve me shkrim brenda datës 14 shkurt 2022.

21 Do të doja që palët të paraqesin pikëpamjet e tyre tani  
22 për sa vijon nëse nevojiten argumente të tjera shtesë për këtë  
23 gjë ose nëse preferojnë diskutime *inter partes*, siç kanë  
24 sugjeruar disa prej ekipeve. Deri ku një seancë e tillë do të  
25 mund të zhvillohet në formë publike. Dhe, në fund, nëse palët

1 do të ishin disponibël ditën e martë, datë 22 shkurt, pas  
2 dreke, nëse do të programohet një seancë e tillë.

3 Fillimisht ja jap fjalën ekipit Mbrojtës të Thaçit që ka  
4 bërë dhe kërkesën.

5 Zoti Kehoe, keni fjalën.

6 Z. KEHOE: [Përkthim] Faleminderit për fjalën, i nderuar  
7 Gjykatës.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Më duket se mikrofonin nuk  
9 e keni shumë mirë. Po shikoje tjetrin.

10 Z. KEHOE: [Përkthim] Janë telat që janë zgjatur disi.

11 Ne do t'i kërkonim Gjykatës një seancë. Është me shumë  
12 rëndësi. Qëndrimi që sugjeron ZPS-ja është tejkalimi i  
13 kompetencave, hyrje në privilegjin avokat-klient dhe është i  
14 pabazuar. Ne duhet t'i diskutojmë këto çështje për atë që ne  
15 kemi propozuar që të merret në konsideratë nga i nderuari  
16 Gjykatës. Një çështje e cila është dhe e paqëndrueshme.

17 Prandaj, ne do të ngulnim këmbë që të bënim një seancë po  
18 më datë 22. Patjetër jemi disponibël. Dhe është ekipi i Thaçit  
19 që në mënyrë absolute dhe kategorike e ka kërkuar këtë seancë.

20 Sa i takon çështjes së paraburgimit, i nderuar Gjykatës.  
21 E kam parashtruar këtë çështje thjesht për shkak të faktit se  
22 ka një apelim i cili është nën gjykim për momentin. Por, po  
23 kërkonim një farë udhëzimi nga i nderuar Gjykatës. Nëse, i  
24 nderuar Gjykatës dëshiron diçka apo jo, se parashtrimet e bëra  
25 nga policia kosovare për të cilat ZPS-ja ka vendosur që t'i

1 kritikojë dhe i ka thirrur në njëfarë mënyre të korruptuar, pa  
2 e quajtur kështu publikisht, sigurish, por pas dyerve të  
3 mbyllura dhe në mënyrë konfidenciale. Por parashtimi ynë  
4 është që një seancë tjetër për këtë çështje do të ishte e  
5 nevojshme në mënyrë që i nderuar Gjykatës t'i kërkonte  
6 policisë së kosovare apo ndonjë pale apo ndonjë vendi të  
7 tretë, të bëhen pyetje për organizimin e lirimit të përkohshëm  
8 në procedurë paraprake. Është e pamundur që të jepet çdo  
9 informacion që mund të dojë i nderuar Gjykatës.

10 Unë e kuptoj që Gjykata ka pyetjet e veta. Metodika e  
11 duhur, që unë do të parashtroja, për të nderuarin Gjykatës,  
12 është që t'i sjellë këta persona këtu, t'i ulë tek stenda e  
13 dëshmitarit dhe t'u bëjë pyetje për metodikën që përdorin,  
14 qoftë kjo policia kosovare apo dhe ndonjë vend tjetër i tretë.  
15 Unë vetëm këtë kërkoj.

16 Dhe kjo qasje do të ishte shumë e dobishme për të sqaruar  
17 Gjykata çdo pyetje që mund të ketë mbetur pa marrë përgjigje.  
18 Unë jua kërkoj që këtë ta bëni sa më shpejt.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zoti Kehoe.

20 Zoti Emmerson, sa i takon propozimit për të parashikuar  
21 një seancë enkas për kërkesën e ZPS-së për trajtimin e  
22 informacionit konfidencial.

23 Z. EMMERSON: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Për të dyja  
24 argumentet e ngritura nga zoti Kehoe, ne mbajmë qëndrim që i  
25 mbështesim me entuziazëm.

1 Sa i takon të dytës, besoj ju kujtohet, unë këtë e kam  
2 kërkuar që në kërkesën e parë për lirim të përkohshëm, që nuk  
3 mund të rrëzohet kjo kërkesë pa dëgjuar dhe drejtorin e  
4 policisë. Një prej aspekteve të Apelit është që të bëhej  
5 pikërisht kjo. Në apelim nuk është punuar mjaftueshëm për këto  
6 kërkesa të cilat ne kërkojmë. Pra, ne e shikojmë që janë  
7 paraqitur dëshmi dhe prova që janë të pamjaftueshme për  
8 vendimin e kësaj.

9 Prandaj dhe ne mendojmë se është më se e volitshme që ta  
10 bëjmë këtë seancë më datë 22 shkurt.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zoti  
12 Emmerson.

13 Zoti Young.

14 Z. YOUNG: [Përkthim] Ne i mbështesim fuqimisht  
15 parashtrimet e bëra nga zoti Kehoe në emër të zotit Thaçi.

16 Ky është një diskutim i cili duhet bërë. Nuk ka arsye pse  
17 të mos bëhet publike, sepse është mbi aspektet juridike të  
18 çështjes. Kjo do të na jepte mundësi që t'i sqaronim shumë  
19 shpejt dhe me efikasitet çështjet. Prandaj, unë e falënderoj  
20 të nderuar Gjykatës, që e kanë marrë këtë në konsideratë dhe  
21 ka vendosur datë.

22 Sa i takon vetë datës, data 22 shkurt është e volitshme  
23 për ne.

24 Faleminderit.

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zoti Young.

1 Zonja Alagenda.

2 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, ne e  
3 mbështesim qëndrimin e mbajtur nga të gjitha ekipet përkatëse  
4 për të njëjtat arsye.

5 Sa i takon datës, do të donim që t'ju drejtohem pas  
6 pushimit.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zonja  
8 Alagenda.

9 Zoti Prokurore, ju lutem.

10 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.  
11 Sa i takon kontakteve me dëshmitarët dhe informacionet  
12 konfidenciale parashtrimet janë bërë me shkrim. U është dhënë  
13 mundësi palëve që të bëjnë parashtrime, po kështu edhe Zyrës  
14 Administrative. Por nëse i nderuar Gjykatës e konsideron të  
15 nevojshme që të bëjë seancë edhe pas marrjes së këtyre  
16 parashtrimeve, ne jemi disponibël më datë 22 shkurt.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zonja  
18 Prokurore.

19 Tani i drejtohem zotit Laws, ju lutem.

20 Z. LAWS: [Përkthim] Faleminderit. Ne nuk mbajmë ndonjë  
21 qëndrim nëse parashtrimet duhen mbajtur gojarisht apo me  
22 shkrim, por sa i takon rezultatit të kësaj kemi qëndrim sepse  
23 është një çështje me shumë rëndësi për viktimat që janë edhe  
24 dëshmitarë në këtë çështje gjyqësore.

25 Prandaj, në të njëjtën mënyrë, cilado mënyrë s'ka



1 problem, data 22 shkurt është e volitshme për ne, nëse është e  
2 nevojshme të mbahet një seancë gojarisht.

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zoti Laws.

4 Zoti Nilsson, dëshironi të merrni fjalën.

5 Z. NILSSON: [Përkthim] Asgjë për të shtuar jemi  
6 disponibël për këtë seancë.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zoti Nilsson.

8 I ftoj palët që t'i përgjigjen parashtrimeve të Zyrës  
9 Administrative me shkrim përpara datës 14 shkurt dhe të  
10 informojnë Njësinë e Menaxhimit Gjyqësor për disponibilitetin  
11 lidhur me datën 22 dhe do të marrim një vendim menjëherë pas  
12 datës 14 shkurt nëse do ta programojmë - apo jo - seancën në  
13 bazë të parashtrimeve tuaj me shkrim.

14 Të kalojmë tani tek tema e parë që është parashikuar në  
15 urdhrin e caktimit të datës që është nxjerrja e materialeve.  
16 Si zakonisht do t'ia jap fjalën palëve për nxjerrjen e secilës  
17 kategori të materialit veçmas.

18 Së pari, materiali i rregullës 102(1)(b) që është  
19 materiali që ZPS-ja synon ta përdorë në gjykim. I ftoj palët,  
20 gjithashtu, të na përditësojnë lidhur me rubrikat e  
21 dëshmitarëve në Legal Workflow gjatë këtij raundi të  
22 diskutimeve.

23 Së dyti, materiali i rregullës 102(3) që është materiali  
24 i rëndësishëm për çështjen gjyqësore, siç është parashikuar  
25 nga ZPS-ja.

1 Së treti, materiali i rregullës 103 që është materiali  
2 shfajësues.

3 Dhe, në fund, materiali i rregullës 107, që është  
4 material i mbrojtur për të cilën kërkohet dhënia e pëlqimit  
5 nga dhënësi i informacionit.

6 Fillojmë me nxjerrjen e materialit të rregullës  
7 102(1) (b).

8 Në konferencën për ecurinë e çështjes të datës 29 tetor  
9 2021, e shtyva afatin për nxjerrjen e materialit të mbetur të  
10 rregullës 102(1)(b) dhe për përkthimin re këtij materiali për  
11 në datën 31 janar 2022.

12 Gjatë konferencës së fundit për ecurinë e çështjes ZPS-ja  
13 bëri të ditur se nuk kishte përfunduar ende çështja e  
14 përkthimeve në anglisht të 496 materialeve dhe përkthimit në  
15 shqip të 545 materialeve. ZPS-ja përmendi se mbeteshin për t'u  
16 nxjerrë më pak se dhjetë materiale të rregullës 102(1) (b).

17 Në parashtrimet e veta me shkrim, ZPS-ja bëri të ditur se  
18 pas konferencës së fundit për ecurinë e çështjes kanë nxjerrë  
19 tre paketa nxjerrje sipas rregullës 102(1) (b) të cilat  
20 përmbanin material të ri dhe tri paketa që përmbanin përkthime  
21 të materialeve të nxjerra më përpara të rregullës 102(1) (b).

22 Vërej se numri i materialeve të nxjerra është ndjeshëm më  
23 i lartë nga sa pritej.

24 ZPS-ja mendon se tani e ka përfunduar nxjerrjen e  
25 materialit ekzistues të rregullës 102(1) (b) përfshirë këtu dhe

1 përkthimet, në varësi të ndonjë vendimi të ardhëm procedural  
2 për kërkesën e fundit të ZPS-së për masa mbrojtëse dhe me  
3 përjashtim të incizimeve audiovizive dhe dy provave materiale  
4 të lidhura, të trajtuara në vendimin që kam lëshuar ditën e  
5 hënë.

6 ZPS-ja ka bërë gjithashtu të ditur se synon që të bëjë  
7 nxjerrjen e lidhur në përputhje me rregulli 102(2) në lidhje  
8 me dëshminë e dy dëshmitarëve dhe këtë do ta bëjë me të pasur  
9 në dispozicion transkriptet përkatëse.

10 Në parashtrimet e veta, Mbrojtja e Thaçit i kërkoi ZPS-së  
11 të konfirmojë nëse ka përfunduar tashmë nxjerrja në përputhje  
12 me rregullën 102(1)(b). Në veçanti, në lidhje me përkthimet në  
13 anglishte të të gjitha dokumenteve të nxjerra si fajësuese nga  
14 ZPS-ja dhe në lidhje me të gjitha materialet e përmendura në  
15 deklaratat dhe në intervistat e dëshmitarëve.

16 I kërkoj ZPS-ja t'u përgjigjet pyetjes së Mbrojtjes, të  
17 bëjë parashtrime për përputhjen midis sasisë së materialit të  
18 nxjerrë dhe vlerësimeve që ka deklaruar më parë në konferencën  
19 e fundit për ecurinë e çështjes dhe të japë një vlerësim më të  
20 mirë për marrjen e transkripteve përkatëse për dëshmitarët e  
21 rregullës 102(2) dhe për të bërë një kërkesë në këtë aspekt.

22 Në fund, u kërkoj palëve që të na përditësojnë lidhur me  
23 diskutimet *inter partes* sa u takon rubrikave të dëshmitarëve  
24 që janë krijuar në Legal Workflow. Për këtë temë, vërej se do  
25 të shtohen nga Zyra Administrative disa metadata të tjera

1 shtesë, përfshi këtu mënyrën e dëshmisë dhe lidhjen me  
2 parashtrimet e tjera të protokolluara me ecjen përpara të  
3 çështjes gjyqësore. Megjithatë, unë vërej këtu dhe shqetësimet  
4 e vazhdueshme të Mbrojtjes lidhur me këtë instrument dhe  
5 kërkesën e tyre për të mbushur këto rubrika të dëshmitarëve me  
6 informacionin përkatës, siç janë emrat e dëshmitarëve,  
7 datëlindjet dhe masat mbrojtëse.

8 U kërkoj palëve që të bëjnë parashtrimet e tyre përpara  
9 këto aspekte; sidomos, ZPS-së për të shpjeguar shqetësimet që  
10 kanë lidhur me mbushjen me të dhëna të rubrikave të  
11 dëshmitarëve.

12 Zoti Prokurore, keni fjalën.

13 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

14 Gjykata është në dijeni për një numër shumë të vogël  
15 materialesh të palëve të treta për të cilat është dhënë një  
16 zgjatje e afatit. Siç e përmendët ju dhe provat përkatëse  
17 materiale dhe incizimet e lidhura me to kanë transkriptet  
18 përkatëse që janë nxjerrë tashmë. Përndryshe, ZPS-ja ka  
19 përfunduar nxjerrjen e materialeve ekzistuese të rregullës  
20 102(1)(b), përfshirë dhe përkthimet. Dhe kjo përfshin dhe  
21 paketat 154 deri në 159.

22 Me kënaqësi do t'ju informoja, të nderuar Gjykatës, me  
23 informacion të përditësuar me materialet e mbetura. Dje kemi  
24 marrë konfirmim zyrtar nga pala e tretë në fjalë që incizimet  
25 në fjalë mund t'i nxjerrë dhe se do të na i nxjerrë këto

1 incizime. Po kështu, dje, jemi informuar se për një prej  
2 këtyre provave materiale të lidhur me këto është marrë  
3 miratimi për t'u dhënë. Kjo do të thotë që ka mbetur vetëm një  
4 material i tillë për të cilin mbetet të merret pëlqimi.

5 Siç e përmendi i nderuar Gjykatës, ka nja dy çështje të  
6 tjera të cilat i kemi përmendur, pra, një çështje tjetër të  
7 cilën ne e kemi përmendur në parashtrimet tona me shkrim për  
8 të pasur dijeni Gjykata. Është nxjerrja sipas rregullës 102(2)  
9 dhe parashtrimi i protokolluar përkatës të cilin synojmë që ta  
10 dorëzojmë.

11 Me sa kam dijeni mbetet vetëm përkthimi në gjuhën shqipe  
12 i njërës prej këtyre intervistave, mendojmë se do të jetë gati  
13 në të ardhmen e afërt. Dhe me t'u bërë gati, do të bëjmë edhe  
14 kërkesën tonë. Kur them "e ardhmja e afërt" e kam fjalën për  
15 javën e ardhshme.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] I parapritë pyetjes që do  
17 bëja.

18 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Po. Pikërisht.

19 Ka dhe një gjë tjetër të cilën do ta përmendja që të ketë  
20 dijeni Gjykatësi dhe palët. Po zhvillohet një proces gjyqësor  
21 përpara Trupit Gjyqësor numër I, i cili vazhdon që të nxjerrë  
22 materiale të cilat bien në objekt të detyrimeve të nxjerrjes.  
23 Prokuroria në atë gjykim e ka përfunduar paraqitjen e provave  
24 sot në mëngjes dhe do të jetë e nevojshme për t'u siguruar  
25 nëse i kemi përmbushur të gjitha detyrimet e nxjerrjes në

1 përputhje me këtë.

2 Sa i takon rubrikave të dëshmitarëve. ZPS-ja i ka  
3 përgatitur të gjitha këto rubrika në dhjetor të vitit 2021 dhe  
4 rubrikat e dëshmitarëve janë lidhur me deklaratat paraprake të  
5 tyre dhe me provat përkatëse të lidhura me këto. Ne, në varësi  
6 të ecurisë dhe me ecjen përpara të çështjes gjyqësore, do të  
7 bëjmë edhe lidhjen me parashtrimet e protokolluara përkatëse.

8 ZPS-ja, në fakt, nuk e ka kapacitetin teknik që të  
9 ngarkojë në sistem metadatat për rubrikat e dëshmitarëve në  
10 *Legal Workflow*. Megjithatë, siç e kemi bërë të ditur në  
11 parashtrimet tona me shkrim, ne me kënaqësi do të bënim  
12 organizimet përkatëse përpara t'i vënë në dispozicion Zyrës  
13 Administrative emrat e dëshmitarëve dhe numrat e parashtrimeve  
14 të protokolluara në mënyrë që të bëhet lidhja me to në  
15 rubrikat e dëshmitarëve.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

17 Zoti Kehoe, keni fjalën.

18 Z. KEHOE: [Përkthim] Faleminderit.

19 Ka disa pika, në përputhje me pyetjen e të nderuarit  
20 Gjykatës, lidhur me nxjerrjen sipas rregullës 102(1)(b) dhe  
21 pse numri i këtyre ishe ndjeshëm më i lartë.

22 Ne pas konferencës së fundit për ecurinë e çështjes kemi  
23 marrë 1.954 materiale shtesë. Sipas rregullës 102(1)(b) këtë  
24 të hënë, pra, më datë 31 janar kemi marrë 1.613 materiale nga  
25 ato 1.954 që përmenda. Prandaj një vënie në dispozicion e

1 këtyre materialeve të rregullës 102(1)(b) është në përputhje  
2 me praktikën e zakonshme që bën tashmë Prokuroria që thjesht  
3 na shkarkon neve shumë materiale mu përpara se të zhvillohet  
4 një konferencë, pra, një seancë përpara të nderuarit Gjykatës.

5 Sigurisht, u përmend procesi gjyqësor përpara Trupit  
6 Gjykues numër I, që është çështja kundër Salih Mustafës, besoj  
7 se ka një vendim i marrë aty i cili ka lidhje dhe me  
8 procedurat tona për disa transkripte dhe prova materiale.

9 Ne s'kemi marrë asgjë prej kësaj. Ky gjykim ka kohë që ka  
10 filluar. Prokuroria thotë që e ka përfunduar nxjerrjen sipas  
11 rregullës 102(1)(b), por, në fakt, ende nuk e kanë përfunduar,  
12 sipas mendimit tonë, sepse nuk kemi marrë asnjë lloj  
13 materiali.

14 Sa i takon pjesës tjetër të mbetur të materialit të  
15 rregullës 102(1)(b), të hënën, pra, kemi folur për redaktimin  
16 e dokumenteve. Prokuroria kërkon që të shtojë dhe 132  
17 dokumente, deklarata dhe prova materiale, të cilat ata thonë,  
18 pra, deklarojnë, se i kanë u kanë shpëtuar nga vëmendja. Ata i  
19 kanë redaktuar këto materiale në mënyrë të njëanshme, pa i  
20 kërkuar leje Gjykatës, por thjesht duke i redaktuar vetë.

21 Ne e dinim që Prokuroria do të duhej që ta protokollonte  
22 dosjen sipas urdhrit, të nderuar Gjykatës, më datë 17 dhjetor.  
23 Po a e bëri Prokuroria këtë gjë? Jo. Ne nuk e kemi marrë këtë  
24 dokument para datës 21 dhjetor, pra, vetëm katër ditë më vonë.

25 Nuk pati kërkesë në këtë Gjykatë për ta shtyrë afatin e

1 nxjerrjes të dosjes paraprake Mbrojtjes. Prokuroria, si  
2 gjithmonë, ka vepruar në kokën e vet. Nuk i është drejtuar  
3 fare të nderuar Gjykatës për leje. Vepruan siç deshën. E  
4 dorëzuan në datë 17, e dorëzuan nën vulë dhe ne e kemi marrë,  
5 një kopje të redaktuar, më datë 21 në shkelje të plotë të  
6 urdhrin të të nderuarit Gjykatës.

7 E megjithatë, paraqitemi këtu. Dhe përsëri afati i listës  
8 së provave ishte sipas urdhrin të nderuar Gjykatës dhe nëse  
9 nuk e kam gabim, data 17 dhjetor dhe tani ata shtojnë edhe 132  
10 dokumente të tjera, deklaratat dhe prova materiale, shumë kohë  
11 pas afatit që u ishte caktuar duke i redaktuar në mënyrë të  
12 njëanshme këto materiale. Duke i shtuar ato në listën e  
13 dëshmitarëve si prova të rregullës 102(1)(b).

14 Afatet nuk paskan asnjë vlerë për ZPS-në. Nuk e dinë se  
15 ç'kuptim kanë urdhrat e Gjykatës. Të paktën mund t'i kishin  
16 kërkuar Gjykatësit se dhe e supozojmë që ato mund ta dinin që  
17 para datës 31 janar, ata duhej t'i ishin drejtuar Gjykatës që  
18 t'i redaktojnë këto dokumente. Por nuk e bënë dhe i bënë  
19 redaktimin me kokën e tyre.

20 Dhe tani kemi këto 132 dokumente të tjera të cilat na  
21 vendosen përpara me redakte, si gjithmonë, ZPS-ja redakton  
22 gjithçka.

23 Sa i takon sistemit *Legal Workflow*. Unë do t'i kërkoj  
24 ekipit të Krasniqit që t'i përgjigjen pyetjeve, të nderuar  
25 Gjykatës, sepse janë më të mençur dhe më të aftë se unë për



1 këtë gjë se kam frikë se mos ju them ndonjë gjë që s'jam kam  
2 shumë haberin, prandaj dhe i drejtohem ekipit të Mbrojtjes së  
3 Krasniqit.

4 Shpresoj që i jam përgjigjur pyetjeve të nderuar të  
5 Gjykatës.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zoti Kehoe.

7 Zoti Emmerson, ju lutem.

8 Z. EMMERSON: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Unë do t'i  
9 kërkoj zonjës Annie O'Reilly që të bëjë parashtrimet e zotit  
10 Veseli për nxjerrjen.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

12 Zonja O'Reilly, keni fjalën.

13 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Faleminderit.

14 Ne mbështesim parashtrimet e bëra nga Mbrojtja e zotit  
15 Thaçi. Do shtojmë vetëm këtë, se kërkesa që ka bërë Prokuroria  
16 sipas rregullës 102(1)(b), në paragrafin 3, thotë se  
17 materialet e mëtejshme ose janë marrë midis -- ose vonë, pra,  
18 nga vitit 2021 dhe nga janari i vitit 2022 ose thjesht u ka  
19 shpëtuar nga vëmendja.

20 Ne kemi nevojë që të marrim garanci prej tyre që në  
21 lidhje me materialet e tjera të cilat ata do t'i kenë në  
22 zotërim në të ardhmen, t'i shqyrtojnë nëse bien në rregullën  
23 103 apo në rregulli 102(3), duke qenë se nuk kemi marrë asnjë  
24 përditësim që pas verës sa i takon listës së rregullës 102(3).

25 Nuk e di nëse çfarë mund të them përtej kësaj.

1 Sa i takon sistemit *Legal Workflow*. Po, kemi filluar  
2 diskutimet *inter partes*. Nuk ka shumë për të shtuar për këtë.  
3 Nuk është ndonjë sistem kushedi sesa i dobishëm. Po përpiqemi  
4 të shikojmë nëse ka ende hapësirë për të punuar apo për  
5 përmirësim.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

7 Z. KEHOE: [Përkthim] Dëshironi që t'jua bëjmë  
8 parashtrimet tona për rregullin 102(3) tani apo më vonë?

9 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Më vonë.

10 Zoti Young.

11 Z. YOUNG: [Përkthim] Ka një gjë shtesë që dëshiroj që të  
12 shtoj, pasi mbështesim parashtrimet e bëra nga Mbrojtja e  
13 Thaçit.

14 Është diçka që e ka cekur Prokurorja. Është që detyrimet  
15 e Prokurorisë sipas rregullës 102(1)(b) në lidhje me  
16 materialet në procedurat e tjera gjyqësore përpara Gjykate, që  
17 pranohen këto si detyrime nga Prokuroria.

18 I vetmi aspekt që dua të ngre është që ky material duhet  
19 të nxirret shumë shpejt duke pasur parasysh edhe afatet e  
20 tjera.

21 Prandaj, i kërkoj të nderuarit Gjykatës që të caktojë një  
22 afat që Prokuroria t'ia nxjerrë këto materiale Mbrojtjes.  
23 Sepse, siç e di i nderuar Gjykatës, materiale të rregullit  
24 102(1)(b) në procedura të tjera të mëparshme, pra, përpara  
25 Dhomave të Specializuara të Kosovës janë të ngjashme me dëshmi

1 të mëparshme të dëshmitarëve.

2 Ju falënderoj.

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zoti Young.

4 Zonja Alagendra, keni fjalën.

5 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Nuk e di në qoftë se zoti  
6 Ellis mund të trajtojë çështjen për nxjerrjen e materialeve.

7 Ju lutem.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Po, patjetër.

9 Zoti Ellis.

10 Z. ELLIS: [Përkthim] Po, ne jemi plotësisht në mbështetje  
11 të parashtrimeve të bëra nga ekipet e tjera të Mbrojtjes.

12 Ndërkohë që sa i takon forumit të punës, siç e tha me të  
13 drejtë zonja O'Reilly, takimi i parë ka ndodhur. Nuk është se  
14 i ka trajtuar të gjitha çështjet që ne kishim, megjithatë, ne  
15 do të mundohemi që ta çojmë përpara procesin *inter partes* pak  
16 më tej përpara se çështjet t'i sjellim në vëmendjen tuaj, i  
17 nderuar Gjykatës.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zoti Ellis.

19 Tani më lejoni t'i kthehem Zyrës Administrative.

20 Besoj se ju keni marrë pjesë në takimin për sistemin  
21 Legal Workflow. A shihni hapësirë për përmirësim, në veçanti  
22 lidhur me atë çfarë tha zonja Prokurore rreth faktit që ju  
23 mund të fusni informacion tek rubrika e dëshmitarëve, siç e  
24 tha dhe zonja Lawson pak më përpara kur foli?

25 Z. NILSSON: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

1 Ju keni të drejtë sa i takon përmbledhjes që bëri zonja  
2 Lawson.

3 Sa i takon rubrikës së dëshmitarëve, kam meta të dhëna të  
4 caktuara të cilat do të jepen dhe do të trajtohen nga Zyra e  
5 Administrimit. Si sqarim, mbase, dua të shtoj që kjo bazë e të  
6 dhënave përfshin gjithashtu edhe të dhëna të mbrojtura të  
7 cilat ne do të kemi mundësi që t'i shtojmë aty. Kaq mund të  
8 them për momentin.

9 Dhe përveç masave mbrojtëse, sigurisht, që ka informacion  
10 të disponueshëm tani dhe ndërkohë më shumë informacion do të  
11 ngarkohet në sistem ndërkohë që dëshmitarëve do i vijë koha që  
12 të japin dëshmi këtu.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zoti Nilsson.

14 Tani më lejoni t'i drejtohem Prokurorisë. Zoti Prokurore,  
15 nuk e di në qoftë se mund të trajtoni pyetjen e Mbrojtjes; që  
16 ka të bëjë me provat materiale të redaktuara. Ose me fjalë të  
17 tjera, redaktimet e bëra në mënyrë të njëanshme prej jush. Po  
18 ashtu do të doja t'ju pyesja për sa i takon çështjes së  
19 dokumentet të cilët janë nxjerrë dhe në qoftë se ato janë  
20 rishikuar në përputhje me rregullin 103. Pra, do të duhet që  
21 të përcaktoni në qoftë se ato janë shfajësuese apo jo. Dua  
22 t'ju pyes gjithashtu edhe lidhur me propozimin për përcaktimin  
23 e afatit kohor për nxjerrjen e materialeve, çështje e cila u  
24 ngrit nga zoti Young. Dhe çështje të tjera në qoftë se keni  
25 për të sqaruar.

1 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Faleminderit. Në fakt, harrova që  
2 t'i përgjigjesha pyetjes që ju bëtë më përpara sa i takon  
3 mospërputhjeve së numrave.

4 Në konferencën e fundit për ecurinë e çështjes, ne u vumë  
5 në dijeni të provave materiale shoqëruese dhe dokumentit më  
6 pak të redaktuar dhe të paredaktuar të cilat janë pjesë e  
7 pakos 154 dhe po ashtu, diskutuam dhe për dy dokumente dhe  
8 dokumentet e tjera, të cilat janë pjesë e paketës 155.

9 E thamë edhe më përpara dhe këtë e kemi parashtruar të  
10 hënën, që kemi 670 dokumente, 60 të tjera, plus përkthimet dhe  
11 133 dokumente të tjera të cilat nuk janë marrë parasysh siç  
12 duhet apo janë anashkaluar dhe nuk janë konsideruar kur kemi  
13 shqyrtuar materialet që kemi parashtruar në kuadër të  
14 rregullit 95(4). Pra, këto janë dokumentet -- është e drejtë  
15 që ne kemi dhënë më 31 janar një pjesë të këtyre dokumenteve  
16 me korrigjimet përkatëse.

17 Ndërkohë që kemi bërë parashtrimin përkatës para Gjykatës  
18 të hënën. Këtë e kemi bërë në mënyrë që dokumentet t'ua u  
19 vinim në momentin e parë të mundshëm në dispozicion ekipeve të  
20 Prokurorisë.

21 Sa i takon shifrës prej 1.954 dokumenteve që u përmend  
22 nga Mbrojtja e zotit Thaçi, kjo këtu pa diskutim që përfshin  
23 dhe përkthime të dokumenteve të cilët janë nxjerrë më përpara.  
24 Në disa raste ka disa përkthime që kanë lidhje me një dokument  
25 origjinal të vetëm dhe kjo shpjegon edhe numrin që nuk është i

1 njëjtë. Ndërkohë numri i cituar është pak çorientues në këtë  
2 kontekst sepse përfshin këtu dhe 341 dokumentet e përfshira në  
3 paketën e nxjerrjes 137 dhe kjo paketë nxjerrjeje kishte të  
4 bënte me materiale që kanë ardhur nga heqja e nxjerrjes së  
5 Mbrojtjeve, e shtyrjes së Mbrojtjeve të nxjerrjeve për  
6 dokumente të caktuar të cilat në atë kohë bënë pjesë në  
7 dosjen paragjyqësore dhe materiale të lidhura me të.

8       Sa i takon dokumenteve të reja të cilat janë marrë në  
9 zyrë, pra, që i kemi ne në zyrë. Ne, aktualisht, po rishikojmë  
10 ato për nxjerrje dokumentesh mbështetur në rregulla të tjera  
11 të Rregullores. Dhe, jam e sigurt, që do t'i cekim ato në  
12 kuadrin e rregullës 103. Dhe do të doja t'ju siguroja që ne,  
13 aktualisht, domethënë po merremi me rishikimin e këtyre  
14 dokumenteve dhe këto janë dokumente, të cilat i kemi marrë  
15 gjatë muajve të fundit në zyrë.

16       Lidhur me materialet nga Trupi Gjykses numër I. Materiale  
17 të caktuara nga ky grup dokumentesh i janë bërë të ditura  
18 Mbrojtjes në këtë çështje. Dhe, siç e përmenda pak më përpara,  
19 Prokuroria e ka mbyllur sot, pak më përpara, shqyrtimin e  
20 këtyre dokumenteve dhe do të bëjnë menjëherë dhënien e këtyre  
21 dokumenteve për Mbrojtjen. Sa i takon afatit kohor, e kemi të  
22 pamundur për të dhënë një afat tani por do t'ju japim atë  
23 sapo të mundemi.

24       Sa i takon dosjes paragjyqësore. Siç e dimë, kjo dosje  
25 paragjyqësore është dorëzuar më datën 17 janar [sipas

1 përkthimit] në përputhje me afatin kohor që ishte përcaktuar.  
2 Ndërkohë është njoftuar të hënën, më datë 20 dhjetor, në  
3 përputhje me praktikën normale të punës ditën e nesërme, pra,  
4 ditën e parë të punës pas parashtrimit. Sigurisht që  
5 parashtrimi ishte shumë voluminoz kishte tre shtojca të mëdha  
6 që kërkonin redaktime të kujdesshme.

7 Faleminderit.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zonja  
9 Prokurore.

10 Zoti Kehoe.

11 Z. KEHOE: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, Prokuroria nuk e  
12 kupton atë çfarë doja të ngrija unë. Shqetësimi im ka të bëjë  
13 me dosjen paraprake në qoftë se ata vendosën që nuk do të  
14 parashtronin dosjen paraprake në afatin kohor të përcaktuar,  
15 duhet t'ju kishin kërkuar leje. Po nuk e bënë fare këtë gjë.  
16 Ata vendosën që parashtronin dosjen atëherë kur donin dhe e  
17 bënë punën ashtu siç donin ta bënë.

18 Tani, çfarë pike ose çfarë logjike ka të pasurit të një  
19 urdhri Gjykate ndërkohë që urdhri nuk respektohet fare?  
20 Ndërkohë që jam i sigurt, i nderuar Gjykatës, që ju keni  
21 menduar që ne do ta merrnim dosjen. Ndërkohë që nuk ka ndodhur  
22 kështu. Ata nuk kanë kërkuar lejen tuaj, i nderuar Gjykatës,  
23 për ta dorëzuar dosjen katër ditë më pas. Prokuroria bën çfarë  
24 i do qejfi për të bërë. Kështu që çfarë vlere ka që ata na e  
25 dhanë neve dokumentin në datën kur donin.

1 Domethënë, ky është një model që Prokuroria zakonisht e  
2 përdorë, domethënë kështu e ka mënyrën e të punuarit. Ata  
3 bëjnë çfarë duan që të bëjnë. I njëjti arsyetim vlen  
4 gjithashtu edhe për 132 dokumente të cilat janë redaktuar në  
5 mënyrë të njëanshme. Pra, ata nuk e morën as mundimin që t'ju  
6 pyesnin juve, i nderuar Gjykatës, që të jepnit leje që ta  
7 bënin këtë gjë përpara 31 janarit dhe nuk mund t'ju pyesnin  
8 juve kemi redaktime të cilat duam që t'ua japim më 31 janar  
9 dhe a është në rregull me Gjykatën në qoftë se neve bëjmë  
10 redaktimin e tyre? As e morën fare mundimin.

11 Dhe mbani parasysh që ditën kur ju keni marrë vendimin  
12 lidhur me provat materiale, dita e vendimit ishte 17 dhjetor.

13 Sa i takon Mbrojtjes së Salih Mustafës, e kam fjalën për  
14 çështjen 05, për këtë arsye ne kemi -- arsyeja është që baza e  
15 krimeve është e njëjta dhe kemi disa dokumente të cilët janë  
16 dhënë. Por sa i takon të gjitha gjërave të cilat kanë ndodhur  
17 gjatë procesit gjyqësor, të gjithë dëshmitarëve, gjithë  
18 provave materiale, ne nuk i kemi marrë ato edhe sot që po  
19 flasim. Nuk i kemi marrë.

20 Kaq kisha për të thënë për këtë çështje. Faleminderit.

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zoti Kehoe.

22 Zonja O'Reilly.

23 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Nuk kam parashtrime të tjera, i  
24 nderuar Gjykatës.

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.



1           Zoti Young.

2           Z. YOUNG: [Përkthim] Jo, nuk kam gjë për të shtuar.

3           GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Zoti Ellis.

4           Z. ELLIS: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] As unë nuk kam  
5 gjë për të shtuar.

6           GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit,

7           Për procesverbal, mendoj që dosja paragjyqësore e ZPS-së  
8 është dorëzuar me datë 17 janar, në mbrëmje, ndërkohë që  
9 versioni konfidencial i redaktuar është parashtruar të martën  
10 më datën 21. Pra, është e vërtetë që është bërë parashtrimi  
11 katër ditë më vonesë, por në praktikë kemi të bëjmë me një  
12 vonesë për një ose dy ditësh pune; apo jo?

13          Z. KEHOE: [Përkthim] Po, është absolutisht e vërtetë, i  
14 nderuar Gjykatës. Por ky është një problem që përsëritet. Në  
15 qoftë se Prokuroria do kishte ardhur te juve, do ju kishte  
16 kërkuar leje për shtyrjen, do të kishim pasur një tjetër  
17 diskutim. Po kjo nuk ka ndodhur. Domethënë, as nuk e kanë  
18 respektuar fare Gjykatën për të kërkuar shtyrjen e nxjerrjes  
19 së dokumenteve deri më datën 21.

20          GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zoti Kehoe.

21          Mendoj që në vendimet në të ardhmen do të përmend  
22 shprehimisht që versionet e redaktuara do të duhen që të  
23 parashtrohen të njëjtën ditë.

24          Le të kalojmë tek njoftimi i rregulli 103 dhe materialet  
25 shkresore.

1           Dua t'u kujtoj palëve që në konferencën për ecurinë e  
2   çështjes më 29 tetor 2021, unë e pezullova afatin kohor për  
3   materiale që kanë të bëjnë me rregullën 102(3). Që prej  
4   konferencës së fundit, ZPS-ja tha që janë nxjerrë shumë paketa  
5   informacioni mbi bazën e rregullës 102(3), 14 për të qenë më i  
6   saktë, të cilat përfshijnë mbi 14.300 dokumente.

7           ZPS-ja, po ashtu tha, që kërkesat që janë ende për t'u  
8   shqyrtuar nuk po përpunohen në mënyrë strikte e kronologjike  
9   por "në mënyrë më efikase për ZPS-në" dhe këtu citoj atë çfarë  
10   ka thënë ZPS-ja. Po ashtu, ajo tha që ka pasur mundësi që të  
11   përfshihet me ekipet e Mbrojtjes sa i takon materialitetit të  
12   një numri të kufizuar të dokumenteve të tjerë të kërkuara.

13           Sa i takon afateve të dokumenteve sipas rregullës 102(3),  
14   ZPS-ja mendon që afati kohor i propozuar për 4 mars 2020  
15   [sipas përkthimit] duhet të vendoset për Mbrojtjen për të  
16   parashtruar të gjitha dokumentet sipas rregullës 102(3) dhe në  
17   qoftë se kjo nuk bëhet, atëherë i takon që do të duhet që të  
18   ngarkohet një barrë e panevojshme për të gjitha palët.

19           Mbrojtja parashton gjithashtu që nuk duhet të  
20   përcaktohet asnjë afat për një gjë të tillë.

21           Mbrojtjet po ashtu thonë që dokumentet mund të bëhen  
22   relevante në mënyra të cilat nuk mund të parashikohen në këtë  
23   fazë. Kështu që ato nuk duhet që të parandalohen që të bëjnë  
24   kërkesa sipas rregullës 102(3) sipas nevojës.

25           Mbrojtjet po ashtu shqyrtojnë që të duhet të kenë

1 mundësinë që të bëjnë rishikim të mëtejshëm të njoftimit sipas  
2 rregulle 102(3) dhe të bëjnë kërkesa të reja aq herë sa  
3 kërkohet informacion i ri.

4 Megjithatë, disa skuadra, disa ekipe Mbrojtjeje kanë  
5 thënë që mund të jenë në pozitë që të propozojnë një afat  
6 tjetër për sa i takon dokumenteve të rregullës 102(3) në  
7 konferencën e radhës.

8 Së fundi, dua të vërej që Mbrojtja e Krasniqit mbështet  
9 propozimin sa i takon afateve kohore të ZPS-së për materialet  
10 e rregullës 102(3) dhe kërkon që afati duhet të vendoset po  
11 ashtu sipas parashikimeve përkatëse.

12 Mbrojtja e Krasniqit gjithashtu kërkon që ZPS-ja të japë  
13 të gjitha dokumentacionet dhe *spreadsheet*-et përkatëse të  
14 rregulli 102(3) lidhur me dokumentet të cilat do të duhet që  
15 të nxjerrën dhe cilat nga dokumentet mbeten ende për t'u  
16 nxjerrë.

17 Tani më lejoni që t'i kërko palëve që ta na informojnë  
18 lidhur me diskutimet *inter partes* mbi këtë çështje dhe në  
19 veçanti të flasim për kalendarin e nxjerrjes së materialeve  
20 sipas rregullit 102(3).

21 Zonja Prokurore.

22 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

23 Sa i takon dokumentacionit sipas rregulli 102(3). Që prej  
24 konferencës së fundit mbi ecurinë e çështjes dhe në kohën e  
25 parashtrimeve me shkrim, ne kemi nxjerrë 14 paketa të tjera të

1 cilat përmbajnë më tepër sesa 14.300 dokumente. Siç e kemi  
2 bërë në mënyrë të vazhdueshme gjatë javëve në vijim, ka paketa  
3 të tjera të nxjerra sot të cilat përfshijnë mbi 3.000  
4 dokumente të tjera shtesë.

5 Siç është shpjeguar në parashtrimet me shkrim, neve nuk i  
6 kemi trajtuar në mënyrë kronologjike dokumentet dhe kjo ka  
7 ndodhur për arsye të ndryshme. Së pari, në mënyrë të tillë që  
8 secili prej ekipeve të Mbrojtjes të mund të marrë materiale në  
9 mënyrë të rregullt. Së dyti, në mënyrë që informacioni të  
10 përpunohet më shpejt dhe të jepet më shumë informacion dhe t'i  
11 vihet në dispozicion sa më shpejt të jetë e mundur ekipeve të  
12 Mbrojtjes. Dhe, së treti, neve na ndihmon në procesin e  
13 redaktimit në qoftë se kemi informacione të të njëjtës natyrë  
14 dhe në qoftë se kemi materiale të cilat kanë të bëjnë me masa  
15 mbrojtëse.

16 Për shembull, ka ndodhur që kërkesat e tjera të mëparshme  
17 të Mbrojtjes së Krasniqit nuk janë përfunduar plotësisht,  
18 megjithatë, ne kemi trajtuar thuhetse 80 për qind të kërkesave  
19 që kemi marrë deri më 13 janar. Në mënyrë të ngjashme, kemi  
20 marrë një kërkesë nga ekipi i zotit Veseli për rreth 2.300  
21 dokumente, dhjetë ditë më përpara, pra, më 1 shkurt, ndërkohë  
22 që sot, pra, kemi thuhetse 90 për qind të këtij informacioni të  
23 këtyre dokumenteve të cilat i janë vënë në dispozicion  
24 Mbrojtjes.

25 Ndërkohë ne nuk mendojmë se materialiteti i çështjeve që

1 janë kërkuar dhe ne kemi përzgjedhur që të kundërshtojmë  
2 aspektin material sa më pak të jetë e mundur. Këtë gjë e kemi  
3 bërë në mënyrë që të maksimizohet, të rritet në maksimum  
4 nxjerrja e informacionit dhe që të ulen po ashtu edhe  
5 kundërshtimet. Pra, siç e kemi bërë edhe në parashtrimet me  
6 shkrim, neve jemi përfshirë në diskutime lidhur me aspektin e  
7 materialitetit për çështje të caktuara.

8 Siç e përmblohdhët dhe ju i nderuar Gjykatës, sa i takon  
9 propozimeve të afateve kohore për kërkesat dhe materialet për  
10 të nxjerrë sipas rregullës 102(3), ne jemi të shqetësuar sa i  
11 takon përcaktimit të afatit kohor nga dy aspekte. Së pari, kjo  
12 mund të çojë në kërkesa për informacione të materialeve të  
13 cilat nuk mund të vihen të dispozicion dhe ndërkohë nga ana  
14 tjetër mund të kërkohen informacione të cilat mund të kenë  
15 vetëm thjesht lidhje tangjentale në rastin më të mirë me  
16 dokumentin. Megjithatë, vënia e afatit kohor mund të çojë që  
17 të kërkohen të gjithë dokumentet dhe kjo mund të çojë  
18 gjithashtu edhe në një barrë të tepruar për të gjitha palët.

19 Nga perspektiva e ZPS-së, ne po vazhdojmë që të  
20 balancojmë shumë përparësi dhe kërkesa emergjente dhe kërkesat  
21 dhe afatet e shumta të vendosura lidhur me materialin 102(3)  
22 cenojnë rishikime të tjera përfshirë këtu edhe përpjekjet për  
23 të përfunduar rishikimin e materialit shfajësues. Kjo është  
24 diçka e cila do të bëhet pjesë e agjendave tona së shpejti dhe  
25 duam që t'ju tërheqim vëmendje lidhur me konstatime dhe

1    parashtrimet tona dhe çështjet e tjera të mbetura që kanë  
2    lidhje me rregullën 102(3).

3           Po ashtu lidhur me parashtrimet me shkrim ne do të  
4    kërkojmë këto lloj afatesh për kërkesat ose për përpunimin që  
5    të mund të përcaktohen prej jush dhe të mund të kemi më tepër  
6    efikasitet të procesit dhe të mos kemi probleme të tjera në  
7    mënyrë që këto çështje të mos ndahen.

8           Mendoj që ka edhe një tjetër çështje të fundit që më  
9    kërkuat që ta shqyrtoja?

10          GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Është çështja e Mbrojtjes  
11    së Krasniqit që ka të bëjë me ofrimin e një dokumenti të madh  
12    përfshirës të dokumenteve të cilat janë të nxjerra mbështetur  
13    në rregullën 102(3) sepse paketat e nxjerra që ju i keni dhënë  
14    Mbrojtjes nuk përkojnë, nuk ka përkim të numrave të  
15    dokumenteve.

16          ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Po.

17          Ne kemi dhënë *spreadsheet* për një tabelë përmbledhëse për  
18    nxjerrjen e informacionit dhe ajo përfshinë informacion për  
19    dokument të cilat nuk janë nxjerrë; për shembull, në qoftë se  
20    kërkesa është tërhequr pas diskutimeve për elementin material,  
21    ose në qoftë se është kërkuar ose është parashtruar një  
22    kërkesë për Mbrojtjen, për masa mbrojtje për këtë dokument ose  
23    në qoftë se kemi të bëjmë me dokumente të dublikuara, të  
24    mbivendosura.

25          Ndërkohë që në dokumentet e kërkuara ne do të vazhdojmë

1 që të përfshijmë informacione lidhur me dokumentet e kërkuara  
2 në këtë *spreadsheet*, në këtë dokument përmbledhës, lidhur me  
3 vendin ku gjenden dokumente të tilla pasi të përfundohet  
4 kërkesa përkatëse. Dhe njëri prej ekipeve të Mbrojtjes na ka  
5 kërkuar që të shtojmë numrin e dokumenteve në mbështetje të  
6 nxjerrjes që na kërkohet mbështetur në rregullën 102(3) dhe do  
7 të duam t'ju themi që do ta bëjmë një gjë të tillë në vijim e  
8 sipër.

9 Megjithatë, është e pamundur që të vendosim numra për  
10 secilën prej paketave të informacionit që nxirren, sepse shumë  
11 prej dokumenteve trajtohen paralelisht ndërkohë që siç e dimë  
12 këto tabelat përmbledhëse duan kohë për t'u trajtuar.

13 Megjithatë, duke marrë parasysh vendimet për masat  
14 mbrojtëse si dokumenti dhe si kërkesa që u ngrit nga zoti  
15 Thaçi sot, do të doja të thoja që çdo dokument sipas rregullës  
16 102(3) lidhet me një kërkesë specifike. Ne i dërgojmë ekipeve  
17 të Mbrojtjes emaile që ju shpjegojmë se me cilën kërkesë  
18 lidhet secila prej paketave të informacionit që ju japim  
19 atyre. Mbështetur në atë çfarë ne kemi marrë në bazë të  
20 përkohshme pastaj, mbështetur në këtë, varet nga ekipet e  
21 Mbrojtjes për të vijuar me punën dhe me specifikimet e  
22 mëtejshme.

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Zoti Kehoe.

24 Z. KEHOE: [Përkthim] Dua të flas për thelbin e  
25 dokumenteve nën rregullën 102(3). Por, unë dëgjova Prokurorinë

1 sot, që na thanë që na janë vënë në dispozicion, na janë  
2 nxjerrë informacionet neve dhe unë do të doja që këto  
3 dokumente t'i merrja njëra pas tjetrit dhe pastaj ju të  
4 kuptoni vetë se çfarë sesi është situata.

5 Kjo është nxjerrja e parë, faqja 1, faqja 2, 3, 4, 5, 6,  
6 7, 8. Pra, kjo është nxjerrja e parë për kërkesat që kanë të  
7 bëjnë me rregullën 102(3).

8 Ndërkohë që për nxjerrjen tjetër janë vetëm dy faqe. Por,  
9 siç mund ta shikoni, domethënë dokumentet janë të tëra të  
10 zeza.

11 Ndërkohë që nxjerrja e tretë është një faqe vetëm. Dhe  
12 është e gjithë faqja e zezë.

13 Dokumenti tjetër, është e njëjta gjë. Mund ta shikoni dhe  
14 vetë kemi dy faqe lidhur me këtë nxjerrje.

15 Pra, kur flasim për nxjerrjen e materialeve nën rregullën  
16 102(3) dhe kur ne bëjmë kërkesat lidhur me 102(3) dhe i kemi  
17 bërë këto kërkesa në mënyrë të kufizuara, fatkeqësisht, këto  
18 marrim mbrapsht nga Prokuroria. Pra, Prokurorja kur foli për  
19 nxjerrjet e materialeve sot, ajo tha që nxjerrjet e 102(3) --  
20 e kam bërë sot dhe këta na e ka nxjerrë sot, këtë na e kanë  
21 dhënë sot në fakt.

22 Sa i takon çështjeve të 103 ka ende kërkesa të cilat janë  
23 pezull dhe që nuk janë përgjigjur nga Prokuroria dhe ndërkohë  
24 do kemi kërkesa të tjetër që kanë të bëjnë me 103 dhe nuk kanë  
25 të bëjnë vetëm thjesht me informacion që kemi marrë të hënën



1 që shkoi 1.900 e ca dokumente, 1.961 dokumente, por edhe  
2 dokumentacioni në vazhdimësi që do të jepet për çështje të  
3 cilat janë pjesë e aktakuzës dhe e dosjes gjyqësore paraprahe.

4 Dua t'ju bëj një pyetje zoti Gjykatës. Në paragrafin 112  
5 të paketës, ata akuzojnë klientin tim dhe zotin Veseli për  
6 sjellje të papërshtatshme lidhur me aktivitetet të cilat kanë  
7 ndodhur në qershor 1998. Ndërkohë që pjesa tjetër në formacion  
8 është e gjitha e redaktuar nuk merr vesh dot se çfarë ka  
9 ndodhur, kur ka ndodhur. Kështu që si është e mundur që ne të  
10 bëjmë një kërkesë mbështetur në rregullën 102(3) dhe ky është  
11 vetëm thjesht një prej shembujve se ka shumë e shumë shembuj  
12 të tjerë të ngjashëm.

13 Por, megjithatë si është e mundur që ne të bëjmë një  
14 kërkesë në mbrojtje të klientit tim, për shembull, mbështetur  
15 në këtë informacion se pjesa më e madhe e informacionit është  
16 e redaktuar? Kështu unë nuk kam asnjë lloj informacioni  
17 mbështetës mbi të cilin mund të bëj kërkesën se nuk di asgjë.  
18 Di vetëm që bëhet fjalë për qershorin e 1998-s. Ndërkohë që  
19 presa i takon provave materiale, nuk kam asgjë në duar kam  
20 vetëm këto fleta të zeza.

21 Ka gjithashtu edhe 106 dëshmitarë anonim, ndoshta një  
22 pikë tjetër do ta diskutojmë, domethënë, mund të jenë  
23 dëshmitarë të cilët neve të na bëhen të ditur disa ditë  
24 përpara sesa të bëhet gjykimi, 30 ditë përpara këtij  
25 informacioni. Po ideja është që, në momentin kur neve të

1 konstatojmë se kush janë këta njerëz sigurisht që do kërkojmë  
2 informacion mbështetur në 103-in.

3 Kështu që kemi gjithë këtë hendek të madh lidhur me ato  
4 dokumente që duhet të kemi në posedim dhe çfarë kemi në duar.  
5 Dhe, sigurisht, që informacioni, pra, del rast pas rasti, siç  
6 e tha dhe Prokuroria. Pra, Prokuroria tha që ka dhe ende  
7 dokumente të cilat ata duan që t'i fusin në listën e provave  
8 materiale.

9 Çdo afat kohor që mund të përcaktojmë këtu, është i  
10 parakohshëm, i nderuar Gjykatës. Nuk e kemi fare idenë pra, në  
11 emër të klientit tim, domethënë, nuk kemi fare idenë, nuk kemi  
12 informacionin e nevojshëm, nuk kemi faktet në mënyrë që të  
13 bëjmë kërkesën. Kështu që ndoshta kjo është një prej gjërave  
14 për të cilat ne kemi rënë dakord që është mirë që të biem  
15 dakord sa i takon datës. Dhe mendoj që datën nuk mund ta  
16 përcaktojmë tani sepse na duhet një listë që na të na japë më  
17 shumë informacion, për shembull, është e pamundur që të thuash  
18 në 4 mars ose nuk e di se çfarë, se nuk e dimë se çka do të  
19 ndodhë deri atëherë.

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Në rregull.

21 Zoti Emmerson, zonja O'Reilly.

22 Z. EMMERSON: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Zonja  
23 O'Reilly do të shtojë.

24 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar  
25 Gjykatës.

1 Sa i takon statistikave. Ne tani kemi kërkuar 19.487,  
2 ndërkohë deri para pak orësh, neve na janë dhënë vetëm 8.428  
3 dokumente nën rregullin 102(3).

4 Pozicioni ynë fillestar, është që nuk duhet të  
5 përcaktohet një afat kohor. Megjithatë, në qoftë se do të  
6 duhet me patjetër të vendosni një afat, ne besojmë që do të  
7 kemi në pozicion që ta trajtojmë afatin kohor në konferencën e  
8 ardhshme. Por zonja Lawson, absolutisht, ka pak të drejtë sa i  
9 takon nevojës për përcaktimin e afatit kohor.

10 Dua të shtoj po ashtu që deri tani nuk kemi marrë asnjë  
11 nga këto fletët përmbledhëse, *spreadsheet*-et që përmendi zonja  
12 Lawson ndoshta për shkak të faktit që nuk i kanë përfunduar  
13 kërkesat që ne kemi bërë. Kështu që do të doja që të na jepej  
14 sqarim lidhur me këtë çështje.

15 Dhe, në qoftë se do të vendoset një afat, po gjithsesi e  
16 kemi parashtruar dhe në -- do ta bëjmë parashtrimin me shkrim  
17 dhe duhet të themi që nuk duhet që afati të jetë përfundimtar.  
18 Dhe duhet të kemi lehtësinë që të bëjmë kërkesë edhe pas  
19 përfundimit të afatit kohor.

20 Por, megjithatë, kjo është diçka që funksionon në dy  
21 drejtimet në kuptimin që edhe ZPS-ja, në qoftë se ajo do të  
22 vazhdojë që të shtojë dokumente në materialin 102(3), gjë të  
23 cilën e dëgjuam pak më përpara nga Prokuroria dhe ndërkohë që  
24 ata marrin material që nuk është shfajësuar dhe nuk synojnë që  
25 ta përdorin, ne sigurisht që duhet ta marrim dhe këtë parasysh

1 sa i takon përcaktimit të afatit kohor.

2 Ky është një tjetër komplikim që tregon që nuk është e  
3 mundur që të përcaktohej një afat strikt në asnjë mënyrë.

4 Domethënë, ky është parashtrimi që ne kemi lidhur me  
5 dokumentet që bien në rregulli 102(3).

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit. Zoti Young.

7 Z. YOUNG: [Përkthim] Shkurtimisht. Ne mbështesim  
8 parashtrimet e bëra nga Mbrojtja e zotit Thaçi.

9 Atëherë sa për t'ju thënë një ide të madhësisë së  
10 situatës së rregullës 102(3) për sa na takon neve në emër të  
11 zotit Selimi, ne kemi kërkuar 52.000 dokument. Kemi marrë deri  
12 tani vetëm 9.000 dokumente të cilat janë nxjerrë mbështetur në  
13 kërkesën për nxjerrje dokumentesh nën rregullën 102(3).  
14 Mbështetur në atë çfarë tha Prokurorja sot, që deri më sot,  
15 ata nuk kanë kundërshtuar ose kanë kundërshtuar shumë pak, le  
16 të themi, aspektin material dhe neve i nderuar Gjykatës,  
17 presim ende që të marrim edhe 43.000 dokumente të tjera në  
18 përgjigje të kërkesës tonë.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zoti Young.

20 Zoti Ellis.

21 Z. ELLIS: [Përkthim] Informacioni për të cilin ne kemi --  
22 që duam të themi është që është shumë e rëndësishme që të dimë  
23 sesa kohë i duhet Prokurorisë që të përpunojë kërkesat ose t'i  
24 përgjigjet kërkesave që kanë marrë. Me ç'ka kam kuptuar nga  
25 transkripti i konferencës së fundit për ecurinë e çështjes,

1 ZPS-ja ka thënë që do të kishte mundësi që të jepte një  
2 përgjigje më specifike dhe më konkrete sot.

3 Neve e kemi parashtruar historikun e kërkesave ne  
4 parashtrimet tona me shkrim. Megjithatë, për një moment më  
5 lejoni që të përqendrohëm tek kërkesa e zotit Krasniqi,  
6 kërkesa e dytë. Që është një kërkesë e cila është parashtruar  
7 më 7 tetor. Lidhet me 5.945 dokumente kjo kërkesë. Ne kemi  
8 marrë përgjigje të ndara në pesë paketa të nxjerra deri tani.

9 Siç u tha edhe në konferencën e fundit për ecurinë e  
10 çështjeve, siç është specifikuar në faqen e transkriptit 794  
11 Prokuroria priste që nxjerrjen e pjesa e mbetur të  
12 informacionit të ishte në janar. Ndërkohë që më 29 janar,  
13 morëm një email dhe na tha që do flasë ZPS-ja për rëndësinë  
14 për pjesën tjetër të dokumenteve që janë më pak sesa 100  
15 dokumente për dy muajt në vijim.

16 Dhe situata është kjo që ja ku jemi këtu katër muaj më  
17 pas ku kërkesa jonë nuk është ka marrë ende përgjigje dhe ende  
18 nuk dimë lidhur me rëndësinë materiale ose me redaktime të  
19 cilat do të duhet që të bëhet. Ndërkohë që bëhet fjalë vetëm  
20 për një kërkesë. Dhe nuk flasim për shumë dokumente të tjera.  
21 Flasim për një dokument, një kërkesë që është modeste që është  
22 më pak sesa 6.000 dokumente.

23 Kështu që thjesht dua të sjellë në vëmendjen tuaj që në  
24 qoftë se nuk përcaktohen afate kohore për këtë proces, procesi  
25 do të vazhdojë për një periudhë të konsiderueshme kohe dhe me

1 të gjithat implikimet e mundshme që ka për hetimet e Mbrojtjes  
2 dhe për menaxhimin e ardhshëm të çështjes.

3 Jemi në mbështetje të plotë të asaj çfarë thanë ekipet e  
4 tjera të Mbrojtjes që në praktikë, sa i takon aspektit praktik  
5 ose mungesës së aspektit praktik lidhur me përcaktimin e fatit  
6 kohor për Mbrojtjet. E kemi thënë edhe në parashtrimet tona me  
7 shkrim që është e rëndësishme që të parashikohen afate kohore  
8 praktike.

9 Neve nuk është se po kërkojmë një përgjigje për tre javë,  
10 por megjithatë është e rëndësishme që të kemi ca afate kohore  
11 në mënyrë që të përqendrohemi dhe mbase të fillojmë që të  
12 cekim fundin, le të themi, e dokumenteve të cilat bien nën  
13 rregullën 102(3).

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Zonja Prokurore, a mund të  
15 na jepni ndonjë parashikim për afatet e përpunimit të  
16 kërkesave të Mbrojtjes sikurse u vu në dukje nga zoti Ellis?  
17 Nuk po ju kërkoj me datë konkrete, duke pasur parasysh se ka  
18 shumë materiale por duam të kemi një ide të përafërt.

19 Keni fjalën.

20 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Po, i nderuar.

21 Ne jemi të gjithë të përqendruar në ZPS duke përpunuar,  
22 duke rishikuar materialet në mënyrë intensive. Aktualisht,  
23 mesatarisht, përpunojmë 5.000 dokumente në javë. Nuk mund t'ju  
24 jap një vlerësim të përgjithshëm. Kemi marrë kërkesa dhe këtë  
25 javë dhe ju kemi përgjigjur po këtë javë.

1 Pra, vërtetë po i japim materialet sa më shpejt që të  
2 kemi pasur mundësi dhe kemi mundësi, në mënyrë që ne e  
3 konsiderojmë efikase për t'i trajtuar kërkesat që marrim. Kaq  
4 mund të them për këtë çështje.

5 Për sa i takon pyetjes së Mbrojtjes së zotit Veseli  
6 lidhur me spreadsheet-et, ato fletët përmbledhëse, do ta  
7 diskutojmë mbas kësaj seance.

8 Për sa i takon masave mbrojtëse, ne kemi bërë kërkesa të  
9 tilla për disa dokumente të njoftimit 102(3). Dokumentet e  
10 nxjerra sot ishin rezultat i redaktimeve të nevojshme për t'i  
11 bërë efikase masat mbrojtëse ekzistuese. Nuk ka ndonjë  
12 boshllëk, mendojmë ne, lidhur me dokumentet e nxjerra  
13 Mbrojtjes.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] 5.000 dokumente në javë  
15 besoj që të gjithë mund ta bëjmë llogaritjen matematikore.  
16 Pra, i bie gjashtë javë që kërkohen që duhet të arrijnë te  
17 konferenca e ardhshme. Pra, 30.000 dokumente.

18 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Mbase është pak sa si shumë  
19 optimiste për shkak të kontrolleve të mëdha që duhet t'ju  
20 bëjmë dokumenteve përpara se t'i nxjerrim. Pra, ndërsa  
21 përgatisim 5.000 dokumente kërkohet shumë punë rishikuese,  
22 kontrolle më përpara.

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Lidhur me kërkesën e  
24 Mbrojtjes së zotit Krasniqi për aftët konkrete për përpunimin  
25 e kërkesave të tyre, a keni ndonjë parashtrim për të bërë për

1 këtë çështje?

2 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Në qoftë se e konsideroni të  
3 nevojshme të na vini një afat lidhur me kërkesën e Mbrojtjes  
4 së Krasniqit, ne mendojmë që duhet ta përmbushim përpara  
5 konferencës tjetër për ecurinë e çështjes, pavarësisht nga  
6 afati.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit. Nuk shoh që  
8 ndonjë nga ekipet Mbrojtëse të marrin fjalën. Pra, mendoj se  
9 është e parakohshme të vendos të rivendosim afat për  
10 materialet e rregullës 102(3). Kështu që i ftoj palët të  
11 vazhdojnë diskutimet midis tyre, pra, *inter partes* si për  
12 materialet që janë objekt i kërkesave ekzistuese dhe për  
13 kërkesa të ardhshme që Mbrojtja do t'i dërgojë zyrës së  
14 Prokurorisë Speciale.

15 Nuk do t'i vendos afat Prokurorisë në këtë konferencë për  
16 përpunimin e kërkesave, por i bëj thirrje ZPS-së që të  
17 përpunojë kërkesat ekzistuese, veçanërisht, ato të dorëzuara  
18 në tetor sa më shpejt që të jetë e mundur. Dhe, siç vutë në  
19 dukje, zoti Prokuror, këto kërkesa do të përpunohen përpara  
20 mbajtjes së konferencës të ardhshme.

21 Të kalojmë tani te materialet e rregulli 103. Që nga  
22 konferenca e fundit, ZPS-ja bëri të njohura dy paketa të tjera  
23 të dokumenteve pontecialish shfajësuese.

24 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Ka një gabim në transkript.  
25 Mbase një kalim.



1 Unë përmenda konkretisht kërkesën e Mbrojtjes së  
2 Krasniqit, por kërkesat janë bërë për më shumë se 40.000  
3 dokumente që janë shumë. Por, sigurisht, ne do të bëjmë  
4 ç'është e mundur që t'i përfundojmë, plotësojmë kërkesat sipas  
5 mundësive.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] E morëm parasysh këtë, do  
7 ta marrim parasysh. Pra, vazhdojmë me materialet shfajësuese.

8 Në parashtrimet me shkrim, ZPS-ja tha se nuk do të bëhet  
9 kërkesë për masa mbrojtëse për këto materiale së shpejti.  
10 Megjithatë, ZPS-ja nuk dha ndonjë vlerësim për kohën e  
11 nevojshme për të finalizuar rishikimin e provave shfajësuese.

12 Në parashtrimet e saj, Mbrojtja e Thaçit kërkon që ZPS-ja  
13 të konfirmojë, së pari, nëse dhe sa dokumente prove  
14 shfajësuese ka në ruajtje, kontroll apo në njohurinë e saj dhe  
15 nëse nxjerrja e materialit të tillë do të përfundojë.

16 Mbrojtja e Veselit kërkon gjithashtu që ZPS-ja të japë  
17 vlerësimin e saj për numrin e materialeve të rregullitës 103  
18 aktualisht në posedimin e saj dhe të japë një datë që të  
19 përfaqësojë vlerësimin më të mirë të ZPS-ja lidhur me  
20 përfundimin e nxjerrjes së materialit të rregullës 103  
21 aktualisht në posedimin e saj.

22 E ftoj ZPS-në t'i përgjigjet pyetjeve të Mbrojtjes.  
23 Theksoj se materialet shfajësuese duhet të nxirren sipas  
24 formulimit të rregullës posa që të jetë në mbajtjen,  
25 kontrollin dhe njohurinë e ZPS-së.

1 Prova të tilla janë absolutisht të qenësishme për hetimet  
2 e Mbrojtjes, por gjithashtu për shpejtësinë e çështjes.

3 Prokurore, keni fjalën.

4 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Faleminderit.

5 Që nga konferenca e fundit kemi nxjerrë dy paketa të  
6 tjera me material potencialisht shfajësues. Paketat 152 dhe  
7 160. Dhe siç vihet në dukje në parashtrimet tona me shkrim, po  
8 punojmë për të përfunduar shqyrtimin e materialeve shfajësuese  
9 që kemi. Ndryshe, shqyrtimi aktualisht është fokusuar në  
10 veçanti në materiale që ose janë marrë nga zyra ose ndryshe  
11 janë miratuar për t'u nxjerrë brenda afërsisht gjashtë apo  
12 shtatë muajsh. Neve, pra, e kemi vazhduar punën në këtë  
13 drejtim. Materialet lidhur me ecurinë dhe statusin aktual,  
14 tani i kemi bërë rreth 50 për qind të shqyrtimit të  
15 materialeve të dokumenteve të marra apo të miratuara.

16 E kam të vështirë të jap një vlerësim por shqyrtimi  
17 vazhdon me një ritëm të shpejtë për këto dokumente dhe  
18 rezultatet e shqyrtimit të bërë ju janë bërë të njohura. Ne  
19 kemi nxjerrë 21 paketa me materiale të rregullit 103, apo janë  
20 përpunuar për nxjerrje duke përfshirë rishikime për redaktim  
21 apo përgatitur për kërkesa për masa mbrojtëse, pra, do të  
22 përpiqemi të përpunojmë sa më shumë dokumente për hatër të  
23 efikasitetit gjyqësor.

24 Një gjë tjetër lidhur me rregullën 102(3) është që  
25 përgatitje për këtë konferencë të sotme, neve kujtuam që në

1 seancën e fundit, Mbrojtja e Thaçit kishte shprehur interes  
2 për të marrë materiale për një individ të caktuar. Është fjala  
3 për dëshmitarin ndërkombëtar, e kontaktuam Mbrojtjen për ta  
4 pyetur nëse do që t'i japë një përparësi ndonjë materiali të  
5 caktuar. Përgjigja e Mbrojtjes ishte që do ta ngrinin çështjen  
6 sot në këtë konferencë, por aktualisht nuk kam informacion  
7 tjetër lidhur me këtë.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

9 Zoti Kehoe.

10 Z. KEHOE: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar.

11 Sigurisht kjo është një çështje që unë e kam ngritur me  
12 ju i nderuar Gjykatës, shumë herë gjatë konferencave të  
13 fundit. Por më lejoni të ngre një çështje më të gjerë që  
14 lidhet me këtë. Kjo lidhet me rregullën 62. Rregulla 62 flet  
15 për detyrat e Prokurorit të Specializuar. Rregulli thotë që:

16 "Në kryerjen e funksioneve të vetë Prokurori i  
17 Specializuar kontribuon në vërtetimin e të vërtetës."

18 "... të vërtetës të Dhomave të Specializuara".

19 I nderuar, a ju kanë informuar ndonjëherë Zyra e  
20 Prokurorisë gjatë seancës së konfirmimit, gjatë seancave a  
21 parashtrimeve lidhur me mocionin e Mbrojtjes për lirimit  
22 paragjyqësor? A ju kanë informuar ndonjëherë, i nderuar  
23 Gjykatës, se diplomatë të lartë të OSBE-së e kanë këshilluar  
24 Prokurorinë para katër vitesh - katër vitesh më parë - se  
25 veprimtaritë kriminale që akuzohen në këtë çështje pas

1 qershorit 1999 janë kryer nga individë që kërkonin një rast  
2 për përfitime personale dhe jo pjesë e një fushate të  
3 organizuar nga udhëheqja shqiptare.

4 Pra, katër vite më parë. Nuk po vazhdoj më tepër me këtë.

5 Individ i cili ka dhënë një informacion të tillë ka qenë  
6 ambasadori Daan Everts. Dhe kush është Daan Everts? Është një  
7 diplomat holandez ka qenë që në vitet 1980, në fillim të  
8 viteve 1980 në Ministrinë e Punëve të Jashtme në Hagë dhe në  
9 vende të tjera. Ai ka qenë shefi i misionit të monitoruesve në  
10 Zagreb pak luftës në ish-Jugosllavi, pastaj shefi i OSBE-së në  
11 Tiranë, pak kohë më vonë.

12 Dhe në korrik të vitit 1999, ambasadori Everts mori,  
13 kryesoi misionin e OSBE-së në Prishtinë, për të gjithë vendin  
14 për zbatimin e planit të paqes dhe për ta modernizuar policinë  
15 dhe për të punuar bashkëpunuar me UNMIK-un dhe EULEX-in për të  
16 sjellë paqe dhe stabilitet në vend.

17 Dhe çfarë i ka thënë ai Zyrës së Prokurorisë katër vite  
18 më parë? E theksova se mendimi i Evertsit ishte që dhuna pas  
19 1999 nuk ishte pjesë e një fushate të organizuar nga udhëheqja  
20 shqiptare.

21 Çfarë tjetër u tha ai? Nëse më lejoni, më falni gjykatës:

22 "Për mendimin tim do të ishte e pasaktë ta quash ngacim  
23 të organizuar sistematik dhe të nxjerrësh përfundimin se është  
24 drejtuar nga lart. Unë e shoh këtë situatë si një situatë  
25 pandëshkueshmërie të njerëzve që duan të ndjekin, të

1 kontrollojnë politikisht për përfitime materiale personale”.

2 I nderuar Gjykatës, në rastin e klientit tim a nuk do të  
3 donit ju të mësonit se çfarë ka thënë ky ambasador për  
4 klientin tim, zoti Thaçi, që ka ndërvepruar me ambasadorin  
5 Everts gjatë gjithë kësaj periudhe kohore? Dhe a nuk do të  
6 donit ju ta mësonit këtë kur e keni shqyrtuar dhe e keni  
7 peshuar kërkesën për lirim të parakohshëm? Lëreni mënjane  
8 dyshimin e arsyeshëm fajin apo pafajësinë.

9 Pra, unë nuk shikoj ndonjë arsye apo motiv se pse Thaçi  
10 do të donte që UÇK-ja të kryente dhunë etnike sepse kjo do të  
11 dëmtonte reputacionin e tij ndërkombëtar. Për mendimin tim,  
12 nuk kishte lidhje midis krimeve dhe udhëheqjes qendrore të  
13 Kosovës, të shqiptarëve të Kosovës. Ndërsa ne po diskutonim  
14 provat, asgjë nga këto nuk ju është dhënë juve i nderuar  
15 Gjykatës, asgjë fare. Dhe këtë informacion ata e kanë pasur në  
16 dorë prej katër vitesh dhe këta katër zotërinj që rrinë në  
17 burg që nga nëntori i 2020-s e kishin këtë informacion dhe e  
18 bënë të njohur që nga 1 shkurti. Pse? Njeriu mund ta pyesë  
19 ambasadorin Everts: Pse ndodhi kjo? Pse u bë kjo gjë? Dhe ai e  
20 ka përgjigjen dhe për këtë.

21 “Për mendimin tim, problemet kryesore ishin mungesa e  
22 medias dhe e një mekanizmi zbatues, ligjzbatues siç është  
23 policia”.

24 Pra, bëhet fjalë për dhunë në terren mbas korrikut 1999  
25 dhe arsyeja pse kjo vazhdoi sipas, problemi kryesor ishte se

1 s'kishte polici. Dhe kush ishte përgjegjës për ngritjen e  
2 policisë? OKB-ja, OSBE-ja, UNMIK-u. Dhe jo katër zotërinjtë që  
3 janë përpara jush. Jo udhëheqja e Kosovës. Ishte kapitull,  
4 ishte një situatë që futet në kapitullin 7 të Kartës së OKB-  
5 së. Ata nuk e kishin të drejtën të organizonin forcën  
6 policore. Këtë të drejtë e kishin ndërkombëtarët.

7 Dhe ç'mund të thuhet për klientin tim, veçan, si individ?  
8 A ishte ai personi që ishte përgjegjës për këtë? A nuk donit  
9 ju ta dinit këtë, ta mësonit këtë kur flasim për konferencën e  
10 Rambujesë?

11 "Mungesa totale e Thaçit..."

12 Mungesë totale e kontrollit.

13 "... është arsye se pse UÇK-ja kishte në role drejtuese  
14 persona si Drini e të tjerë".

15 Ai thotë s'kishte asnjë kontroll, nuk kishte asnjë motiv  
16 që të nxiste dhunën në terren dhe nuk kishte provë që të  
17 kishte një urdhër që vinte nga lart deri poshtë në terren dhe  
18 përsëri ai nuk kishte motiv ta bënte këtë se nuk kishte as  
19 pushtetin të drejtën ta kontrollonte, sidomos në zonat  
20 periferike, ndaj pjesëtarëve të tjerë të UÇK-së.

21 Dhe nuk është e vetmja e gjë që ai përmend këtu.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] E kuptoj, për ne ka rëndësi  
23 kjo që dua të them nga pikëpamja procedurale, që është  
24 material i rregullës 103 dhe duhet të ishte bërë i njohur që  
25 më parë.

1 Z. KEHOE: [Përkthim] Duhet jo vetëm të bëhej e njohur kjo  
2 gjë për ju përpara por këta burra duhet të lirohen. Si pasojë  
3 e mosdijes këta burra të lirohen bazuar në një dokument që ata  
4 e lanë aty, e mbajtën për katër vite.

5 Kjo na çon përsëri tek rregulla 62, ky duhet të jetë një  
6 Tribunal që kërkon të vërtetën. Dhe Prokurori i Specializuar  
7 duhet të përpiqet të gjejë të vërtetën. Ju nuk e keni parë,  
8 pasur kurrë këtë dokument. As ne vetë nuk e kishim deri  
9 përpara të martës dhe ne e morëm dhe do ta tregoj si e morëm.  
10 Të martën si rezultat i përpjekjeve të ambasadorit Everts dhe  
11 trysnisë që i ka bërë Zyrës së Prokurorisë për ta marrë këtë  
12 dokument, të cilin ata e kanë refuzuar ta dorëzojnë.

13 Dhe nuk është e vetmja gjë që s'kanë dorëzuar ata. Ajo që  
14 është shqetësuese dhe besoj që duhet ta shqyrtoni, i nderuar  
15 Gjykatës, është deklarata që u insistua të përfshihej, pra, e  
16 ambasadorit Everts lidhur me kryerjen e këtij hetimi nga ZPS-  
17 ja.

18 Dhe ai shkroi në deklaratën e tij kur fliste për procesin  
19 intervistues të bërë nga ZPS-ja:

20 "Çdo paragraf është i saktë siç është shkruar dhe mund të  
21 rrijë ashtu siç është, tërësia e deklaratës duket se  
22 përfaqëson, tregon një interes më të vogël lidhur me  
23 informacionin inkriminues dhe në informacionin shfajësues  
24 krahasuar me atë inkriminues".

25 ZPS-ja po përgatiste atë që ata e quanin "fakte

1 shfajësuese" apo që duhet të ishin shfajësuese. Si mund ta  
2 përmbushi detyrimin e rregullit 62 ata në bazë të kësaj  
3 qasjeje?

4 Dhe unë them, ky nuk është një incident i veçuar, i  
5 izoluar, lidhur me atë që ata nuk kanë dorëzuar është edhe një  
6 letër marrë nga Departamenti Amerikan i Shtetit në të njëjtën  
7 periudhë kohore më datën 4 maj 1999 nga Barbara Larkin,  
8 Asistente Sekretare e punëve legjislative drejtuar senatorit  
9 Mitch McConnell.

10 Çfarë i thonë një senatori Shtetet e Bashkuara në senatin  
11 e Shteteve të Bashkuar:

12 "Nuk ka strukturë politike apo komandë dhe kontroll  
13 efikas të UÇK-së".

14 Ata e kishin këtë dokument. A mos e dorëzuan ata këtë?  
15 Jo. Dhe me kënaqësi mund t'ju jap një kopje të kësaj letre  
16 nëse doni ta shikoni, sepse kam shumë kopje.

17 Ka disa individë që ata nuk i kanë bërë të njohur.

18 Në paragrafin 13 të Aktakuzës, kryeministri, ish-  
19 kryeministri i Kosovës ishte një person i quajtur Bujar  
20 Bukushi. Zoti Bukushi ka folur me ZPS-në. Intervista ka  
21 përfunduar me një deklaratë të vënë në diskutim nga Prokurori:

22 "Ju duhet të jeni shok me Hashim Thaçin, apo jo?

23 Ne s'kemi marrë kurrë këtë dokument. Asnjë njoftim nëse e  
24 kanë nënshkruar apo jo. Qindra ushtarë të UÇK-së janë thirrur  
25 për të dhënë deklaratë. Ku janë këto deklaratë? Ku janë këto



1 deklarata? Çfarë thonë ato?

2 Ne kemi marrë deklarata që ata i kanë vendosur në listën  
3 e dëshmitarëve që ata besojnë janë shfajësuese. Qindra vetë  
4 janë thirrur për t'u marrë në pyetje nga Prokurori.

5 Dhe ajo që më shqetësuese është situata në rastin e  
6 ambasadorit Everts. Ai ishte ambasador me gradë i OSBE-së. Unë  
7 ju parashtroj se kur Prokurori ka folur me ambasadorin në një  
8 takim privat dhe ju thoshte sesa të tmerrshëm ishin klientët e  
9 mi dhe klienti im do ta kalonte jetën në burg. Ai nuk u tha  
10 asnjëherë, "Zoti Smith tha..." -- mënyra sesi flet ai, a mos  
11 tha ai që Thaçi s'ka qenë fajtor e tjera?

12 Jo, s'ua u ka thënë fare atyre të pranishmëve as juve  
13 s'jua ka thënë që nga ato që ai kishte në posedim këta nuk  
14 janë fajtor dhe se ka një dyshim të arsyeshëm dhe se ata  
15 mbahen në burg në mënyrë të përhershme.

16 Cila është zgjidhja këtu? Ka vetëm një zgjidhje që ne e  
17 vëmë në tavolinë, që kontrolli përmes materialeve goftë dhe  
18 marxhinalisht shfajësuese duhet të bëhet nga një tribunal i  
19 paanshëm sepse këtë nuk mund t'ia lëmë në dorë ZPS-së të cilës  
20 nuk ja kemi besën. Dhe ata nuk e kanë bërë këtë. Në goftë se  
21 ngrihen përpara jush dhe thotë që ua kemi dhënë informacionin  
22 lidhur me versionin sapo e mësua është një budallallëk. Ata e  
23 dinin vite përpara edhe erdhën ata përpara jush dhe ju thanë  
24 një gjë të tillë, "kemi material shfajësues?". Jo, nuk jua  
25 kanë thënë. E kishin dritën jeshile nga misioni i tyre? E

1 kishin për ta bërë që në 2021, më të fundit dhe pjesa tjetër e  
2 dëshmitarëve të OSBE-së, që mendojnë ata se janë fajësues, u  
3 bënë të njohur në gusht në 2021. Pse i lanë jashtë ato që  
4 ishin shfajësuese? Pse nuk e përdorën deklaratën e ambasadorit  
5 dhe vetëm këtë të hënë e bënë të njohur përmes disa emaileve.  
6 Një ambasador ndërkombëtar a i ka thënë atij që nuk mund ta  
7 përdorim deklaratën tuaj sepse s'është pjesë e praktikës së  
8 punës tonë.

9 Ku jemi ne? Ju e keni theksuar disa herë nevojën që  
10 Prokuroria të gjejë materiale shfajësuese. A ka ndonjë gjë më  
11 shfajësuese sesa një deklaratë si kjo e ambasadorit Everts, të  
12 cilit ata i kanë ditur prej vitesh. Në qoftë se ka atëherë  
13 jemi në telash të rëndë.

14 Ajo që ne nuk e dimë, sepse jua kemi marrë në një farë  
15 mënyre me zor -- po ne në këtë rast nuk dimë sesa materiale të  
16 tjera ata nuk i kanë nxjerrë. Ata rrinë në burg që nga nëntori  
17 i 2020. Jemi në shkurt të 2022. Dhe ne na dhanë këtë  
18 informacion në 1 shkurt të 2022, ndërsa këta katër zotërinj  
19 rrinë në njësinë paraburgimit, kurse ata fshihen pas refuzimit  
20 që të flasin në publik për ato që thonë lidhur me policinë e  
21 Kosovës dhe me lirimin e parakohshëm dhe nuk japin materiale  
22 shfajësuese. Kjo gjë duhet të ndalojë. Me gjithë respektin që  
23 kam, kjo gjë duhet të ndalojë.

24 Dhe unë do t'i them ambasadorit Prosper të shtojë dhe ai  
25 komentet e veta.

1 Unë nuk e di cili është kalendari i kësaj Gjykate, por  
2 duhet të ketë një autoritet të paanshëm që ta bëjë këtë punë,  
3 ta ndjekë procesin e nxjerrjes sepse atyre nuk u besohet më.  
4 Me qëllim që këta zotërinj mos të rrinë dhe një ditë, një  
5 sekondë më shumë sesa duhet në njësinë e paraburgimit.

6 Tani me lejen tuaj, do t'ia jepja fjalën ambasadorit  
7 Prosper.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Shkurtimisht zoti Prosper,  
9 sepse zoti Kehoe e përdori, mori shumë kohë.

10 Z.PROSPER: [Përkthim] Unë do të flas sa më shkurt që të  
11 mundem, por kjo është një çështje kritike dhe kërkoj  
12 mirëkuptimin tuaj.

13 Siç e dini, nuk e marr fjalën shpesh në këto procese,  
14 sepse kam kolegun tim të zotë, por e ndjeva nevojën ta trajtoj  
15 këtë çështje sepse është një çështje që ka implikime të rënda.  
16 Ka implikime të cilat janë më të gjëra sesa këto procedura, më  
17 të gjëra sesa Gjykata. Implikimet janë të tilla që  
18 shkatërrojnë i tundin themelet e sistemit të drejtësisë  
19 ndërkombëtare.

20 Jam në pozitë unike për të folur për këtë çështje sepse,  
21 siç e dini, nga historiku im unë jam përfshirë në punën e çdo  
22 trubunali të krijuar ose kam marrë pjesë që nga Nurembergu.  
23 Kam iniciuar, krijuar, jam konsultuar apo kam mbikëqyrur  
24 krijimin e çdo tribunali përfshirë TPNJ, Gjykatën e Timorit  
25 Lindor, Kambodia, Gjykatën Penale Ndërkombëtare, Libanin,

1 Serbinë, Bosnjën. Dhe tani këtu.

2 Këto tribunale mbështeten mbi besim. Mbi besim. Ato  
3 mendohet se duhet të jenë standarde të arta për botën, model  
4 që duhet ta ndjekin sistemet e brendshme të cilat duhet të  
5 aspirojnë të bëhen të tilla. Udhëheqësit politikë në shkallë  
6 botërore duan të vendosin një qëllim që njerëzit të thonë në  
7 qoftë se jeni si këto tribunale si KSC-ja, këto nuk -- kombet,  
8 qeveritë vendosin besimin e tyre në këto procedura që duhet të  
9 jenë përtej dyshimit, që duhet t'i mbijetojnë shqyrtimit qoftë  
10 politik apo historik.

11 Kombe të tilla si Kosova kanë krijuar sovranitetin e tyre  
12 bazuar në këtë besim, me vullnet të lirë besimin e vërtetimit  
13 të së vërtetës. Këto duhet të operojnë me integritetin më të  
14 lartë dhe këtu, në fakt, ka ndodhur që Prokuroria e ka  
15 tradhtuar këtë besim. Prokuroria e ka tradhtuar detyrën e vet  
16 për të provuar të vërtetën kur ata ju drejtuan ju për  
17 konfirmim u dhanë një gjysëm histori. Gjysëm histori e cila na  
18 ka bërë të vijnë këtu ku jemi sot. Në zellin e tyre për  
19 fitore, në zellin e tyre për procedime, ata kanë humbur  
20 funksionin më kritik të Zyrës së Prokurorisë dhe kjo është  
21 ndjekja e drejtësisë. Ajo që është e drejtë. Ajo që është e  
22 ndashme.

23 Përkundrazi, në vend që të lënë faktet që të çojnë në  
24 rezultate, ato vendosën që t'i shtrembërojnë faktet për  
25 qëllimet e tyre. Kjo është një shkelje e të drejtave të

1 njeriut po ta shikosh hollë-hollë. Po të shikosh të gjithë  
2 instrumentet e të drejtave të njeriut, duke filluar nga  
3 Deklarata Universale e të drejtave të njeriut, cila ka qenë  
4 tema që i përçonte të gjitha. Parandalimi i abuzimit me  
5 pushtetin. Mbrojtja e individëve. Mbrojtja e personave të  
6 akuzuar nga prokurorë të pandershëm, sisteme drejtësie të  
7 pandershme. Qëllimi është që të dalë, të vendoset standardi që  
8 mbizotërojë e vërteta dhe drejtësia.

9 Prokuroria ka vepruar pa mbikëqyrje. Siç e dini nga  
10 përvoja, një nga debatet kryesore e tribunaleve ndërkombëtare  
11 është çështja e mbikëqyrjes, sepse të gjithë kanë frikë nga  
12 ato që ndodhin këtu, kur ke një Prokurori që funksionon si  
13 mbas tekave të veta pa i dhënë llogari askujt. Siç tha kolegu  
14 duke nxjerrë materiale kur u do qejfi, duke i paraqitur kur u  
15 do qejfi, duke mbajtur informacion kritik shfajësues për katër  
16 vite duke mos ua dhënë juve, as juve është mashtrim. Mashtrim  
17 që ka nevojë të korrigjohet.

18 Imagjinoni nëse këto për të cilat po flasim kanë ndodhur  
19 në një sistem të brendshëm juridik. Thjesht merreni me mend se  
20 çfarë do të ndodhte dënimet nga grupet e të drejtave të  
21 njeriut, nga qeveritë, nga tribunale mbikëqyrëse  
22 ndërkombëtare. Ata do të thoshin, si guxoni ju që mbani të  
23 fshehtë informacion shfajësues kaq të rëndësishëm? Siç tha  
24 kolegu im, kjo është ajo që dimë vetëm. Vetëm ajo që dimë.

25 Këtu, siç thashë, kemi të bëjmë me diçka që është me e

1 gjerë më e madhe se ky Tribunal. Sepse në qoftë se kjo gjë  
2 lejohet të vazhdojë bëjini vetes pyetjen: Cili vend në të  
3 ardhmen që ka në mendjen -- që ka logjikën e duhur do të binte  
4 dakord të krijonte një tribunal hibrid të tillë apo  
5 ndërkombëtar kur të mësojnë sjelljen e mbajtjes së fshehtë të  
6 informacionit shfajësues dhe kur nuk vërtetohet e vërteta ku  
7 mashtrohet Gjykata, kush do të donte të ishte pjesë e një  
8 tribunali të tillë ndërkombëtar?

9 Pra, i nderuar Gjykatës, është një çështje e madhe e cila  
10 duhet korrigjuar. Dhomat e Specializuara kanë humbur rrugët.  
11 Në qoftë se nuk korrigjohet trashëgimia e kësaj Gjykate  
12 trashëgimia e punonjësve dhe e drejtësisë ndërkombëtare do të  
13 dënohet në mënyrë të pariparueshme. Pra, ta vendosim në një  
14 kontekst. Nuk është fjala për një çështje të vogël, një  
15 problem të vogël që mund të trajtohet në një konferencë për  
16 ecurinë e çështjes. Është shumë më tepër se kaq.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zoti Prosper.

18 Ja jap fjalën ZPS-së. Pasi t'ua jap fjalën ekipeve të  
19 tjerë të Mbrojtjes për t'iu përgjigjur kësaj.

20 Nuk e di përkthyesit më lejojnë që të vazhdoj dhe nja dy  
21 minuta në mënyrë që të mbarojmë debatin për këtë kategori të  
22 nxjerrjes së materialeve.

23 Shoh që Sekretarja e Gjykatës thotë po. Ju falënderoj  
24 shumë.

25 Ja jap fjalën zotit Emmerson.

1           Z. EMMERSON: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Do t'i bie  
2 shkurt. Ka dy gjëra për të cilat dua të flas. Së pari, do të  
3 marr leje, unë do të largohem, pra, deri në atë pjesë të  
4 takimit që ka të bëjë me "çështje të tjera".

5           Tani ajo që dua të them lidhur me këtë është që mbetet  
6 një pasiguri e konsiderueshme lidhur me provat të cilat ende  
7 nuk janë vënë në dispozicion që janë cituar edhe sot dhe kjo  
8 për mua kjo ma bën shumë të qartë se nuk do të kemi ndonjë  
9 qartësi për provat që do të përdorë Prokuroria dhe për  
10 objektin e tyre deri në -- të paktën dhe për disa muaj të  
11 tjerë.

12           Po ajo që do të doja që të përmendja në fund është që, në  
13 fund të konferencës për ecurinë e çështjes do të ngre disa  
14 çështje që ndërlidhen edhe me këto.

15           Për aspekte të hollësishme të provave shfajësuese do t'ia  
16 jap fjalën Anny O'Reilly kur të jepet mundësia.

17           GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zoti  
18 Emmerson.

19           Zonja o'Reilly.

20           ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Do të flas shkurt. Ne u  
21 bashkohemi parashtrimeve që bën ekipi i Mbrojtjes së zotit  
22 Thaçi. Siç kemi cekur edhe më përpara për parashtrimet për  
23 masa mbrojtëse, ne nuk kemi besim tek procesi i identifikimit  
24 nga ana e ZPS-së të materialit të rregullës 103. Duke pasur  
25 parasysh nga sa kemi parë nuk janë të besueshëm. Sigurisht,

1 nuk e kanë nxjerrë të gjithë materialin e rregullit 103, i  
2 cili na takon.

3 Ne jemi në dijeni edhe të dëshmitarëve të tjerë të cilët  
4 bëjnë pjesë në këtë kategori që u përmendën dhe që nuk janë  
5 nxjerrë deri tani. Kështu që desha që theksoj se është një  
6 çështje shumë e rëndësishme dhe që ka të bëjë me thelbin e  
7 këtij gjyqi.

8 Sa i takon kërkesës tonë për qartësim se edhe sa material  
9 të rregullës 103 mund të ketë, vërejmë se nuk kemi marrë ende  
10 përgjigje. Na kanë thënë se janë nxjerrë 21 paketa deri tani.  
11 Për hir të procesverbalit, është 3.583 materiale. Por, ne nuk  
12 e dimë nëse i kanë para të gjitha që kanë marrë deri tani apo  
13 kanë parë vetën 50 për qind.

14 Kështu që do të donim një informacion më konkret në  
15 përgjigje të pyetjes sonë.

16 Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zonja  
18 O'Reilly.

19 Zoti Young, keni fjalën.

20 Z. YOUNG: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, edhe unë shkurt  
21 mund të flas.

22 Atë që ju tha zoti Kehoe në emër të zotit Thaçi është  
23 shumë serioze. Ne mbështesim të gjitha parashtimet e bëra nga  
24 ekipi i zotit Thaçi. Duhet të jetë tashmë e qartë për të  
25 nderuarin Gjykatës sesa i rëndë është ky problem. I nderuar



1 Gjykatës, që në fillim të diskutimit për materiale të  
2 rregullës 103, ne ke kemi cekur rëndësinë që kanë fjalët apo  
3 fraza në rregullën 103 "me të", pra, me t'i pasur Prokuroria  
4 këto materiale. Prokuroria duhet t'ia nxjerrë Mbrojtjes çdo  
5 informacion që ka, pra, me ta pasur në ruajtje, kontroll apo  
6 për të parë dijeni faktike.

7       Flasim për informacione të cilat mund të cenojnë  
8 besueshmërinë e provave të Prokurorit të Specializuar.  
9 Materiali që zoti Kehoe ka përmendur është e qartë që bie në  
10 objektin e kësaj kategorie.

11       Ka një sërë gjërash që duhet të përbëjnë shqetësim nga  
12 ato që dëgjuam. I nderuar Gjykatës me siguri e vuri re, e  
13 dëgjojë që zoti Kehoe shpjegoi këtë dokument jashtë zakonisht  
14 të rëndësishëm nga një figurë tejet e lartë e skenës  
15 ndërkombëtare. Ky dokument është nxjerrë nga vetë Prokuroria,  
16 pra, ka dalë më saktë nga vetë Prokuroria në janar dhe mars të  
17 vitit 2018, pra, para katër vjetësh.

18       Pra, është shumë e vështirë për të kuptuar sesi nuk e  
19 kanë pasur dijeni ata për këtë dokument, kur kanë qenë ata që  
20 e kanë bërë këtë dokument vetë. Dhe rregulla 103 është objekt  
21 i vetëm dy kufizimeve sa i takon nxjerrjes. Janë shumë  
22 specifikë, një ka të bëjë me rregullën 107 dhe 108 tjetri, që  
23 duket se nuk vlen për këtë rast sepse do të bëhet fjalë kur  
24 Prokuroria do t'ju kishte bërë kërkesë zyrtarisht *ex parte* dhe  
25 konfidencialisht dhe ju do të kishit pasur dijeni për këtë.

1 Por duket që ju, i nderuar Gjykatës, nuk keni marrë një  
2 kërkesë të tillë, prandaj dhe ju duhet ta merrni shumë  
3 seriozisht këtë çështje ta çoni deri në fund parashtrim e  
4 ekipit të zotit Thaçi në lidhje me atë që kanë kërkuar ato.

5 Nuk kam gjë tjetër për të thënë këtë çështje kaq të  
6 rëndësishme.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zoti Young.

8 Z. ELLIS: [Përkthim] Janë lexuar disa pasazhe nga  
9 dokumentet, nga deklaratat e zotit Everts. Ato janë  
10 shfajësuese jo vetëm për zotin Thaçi por, sigurisht edhe për  
11 të akuzuarit e tjerë dhe sigurisht edhe për zotin Krasniqi. Ne  
12 jemi thellësisht të shqetësuar sesi këto deklaratat nuk kanë  
13 dalë në një fazë të mëhershme të procedurës.

14 Nuk mund ta kuptojmë sesi përputhet kjo me detyrimin e  
15 rregullës 103, e cila thotë shprehimisht që Prokuroria duhet  
16 t'i nxjerrë materialet e tilla me t'i pasur. Me të pasur  
17 dijeni, me të pasur në zotërim.

18 Pasi i kemi hedhur një sy të shpejtë paketës së nxjerrjes  
19 160 e cila na është nxjerrë më 1 shkurt, ajo që mund të  
20 shikojmë është që janë, për shembull, është një deklaratë aty  
21 e ekipit të -- e Task-Forcës Hetimore Speciale ku ka  
22 intervista të vitit 2014 dhe asnjëri prej këtyre nuk janë  
23 nxjerrë më përpara. Prokuroria i ka pasur këto në zotërim kur  
24 i ka arrestuar këta njerëz. Duhet të na e kishin nxjerrë këtë  
25 material shumë pak kohë pas këtij arrestimi. Prandaj, ju bëjmë

1 kërkesë juve, i nderuar Gjykatës, që të mbroni të drejtat e të  
2 akuzuarve në emrin tonë.

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

4 Z. EMMERSON: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Përpara se  
5 të vazhdoj, i nderuar Gjykatës, ju kërkoj ndjesë, do t'ju  
6 kërkoja që t'i kërkonit Prokurorisë tani të shpjegojë rrethanat  
7 në të cilat ky dokument është mbajtur pa u nxjerrë për një  
8 kohë kaq të gjatë.

9 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zoti  
10 Emmerson.

11 Zonja Prokurore, keni fjalën, si sa i takon dokumentit  
12 konkret i cili u lexua pjesërisht këtu nga zoti Kehoe; arsyeja  
13 për nxjerrjen me kaq vonesë dhe më në përgjithësi për procesin  
14 e nxjerrjes për materialin e rregullit 103.

15 Keni fjalën.

16 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Faleminderit.

17 Në lidhje me materialin e rregullit 103 dhe pyetjen që ka  
18 bërë Mbrojtja e zotit Veseli. Po, materiali i mëparshëm që  
19 është pjesë e njoftimit të rregullës 102(3) është rishikuar  
20 dhe janë marrë dhe miratimet përkatëse. E kemi kaluar 50 për  
21 qindshin e këtij rishikimi.

22 Për t'u kthyer tashti ekipit të Mbrojtjes të zotit Thaçi.  
23 Unë e kuptoj parashtrimin e tyre, e nëse e kuptoj saktë,  
24 domethënë, unë vetëm tani po mësoj që ka lidhje kjo. Kjo,  
25 sigurisht, e pengon dhe aftësinë time për t'u përgjigjur me

1 konkretësi lidhur me këtë material, nga 170 që janë përfshirë  
2 paketat e nxjerrjes sipas rregullës 103.

3 Nëse Mbrojtja do të përdorë këto si prova në gjykim vlera  
4 e tyre do të vlerësohet në kuadër të provave të tjera.

5 Së dyti, paketat e fundit të rregullës 103 janë  
6 përcaktuar nga shqyrtimi që bëhet më mënyrë të vazhdueshme dhe  
7 jo nga hetime të bëra jashtë këtij procesi.

8 Sa i takon kohës, për shumë prej materialeve të nxjerra  
9 në paketat e fundit të rregullës 103, ne kemi filluar të bëjmë  
10 kërkesa për marrjen e miratimit që në fillin të vitit 2019. Ne  
11 jemi treguar korrekt në kërkimin e miratimeve nga palët  
12 përkatëse dhe në bazë të kësaj mund të them se kemi vepruar në  
13 përputhje këtë proces. Ky informacion që ne e nxjerrim mund të  
14 përdoret nga Mbrojtja pastaj për të krijuar dhe pistat e tyre  
15 mbrojtëse. Dhe këtë qëllim përpiqet që të përmbushë edhe ky  
16 proces i nxjerrjes së provave, siç e kam përmendur më përpara,  
17 pastaj Mbrojtja mund të vendosë ose jo që t'i përdorë këto në  
18 kuadër të vet procesit gjyqësor.

19 Dhe këto mund pastaj mund të peshohen si prova të  
20 procesit gjyqësor duke u parë edhe në kuadër të atyre që ka --  
21 të provave që ka vendosur, që ka paraqitur edhe Prokuroria.

22 Zoti Kehoe përmendi edhe një intervistë të dytë, në  
23 veçanti. Nga përgjigjet që kemi marrë duket se Mbrojtja është  
24 më pak e interesuar në marrjen e këtyre materialeve se po ka  
25 më shumë interes që të bëjë parashtrime për të.

1 Ne vijojmë që të bëjmë shqyrtimin në fjalë për nxjerrjen  
2 e materialeve të mundshme shfajësuese dhe do të vazhdojmë këtë  
3 punë me intensitet.

4 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zonja  
5 Prokurore.

6 Shumë shkurt, zoti Kehoe.

7 Z. KEHOE: [Përkthim] Është shumë e vështirë që të qëndroj  
8 pa folur tani që dëgjoj këto që thotë zonja Prokurore.

9 Ajo që unë i parashtrova, të nderuarit Gjykatës, është  
10 ajo që unë lexova atë që na ka dhënë Prokurori. Pra, ishte  
11 mendimi i zotit Everts që aktivitetet kriminale pas qershorit të  
12 vitit 1999 ishin kryer nga individë që kërkonin që të nxirrnin  
13 përfitime personale dhe nuk ishin pjesë e një fushate të  
14 organizuar nga udhëheqja shqiptare.

15 Kjo nuk është thjesht një gjë që e thotë ekipi i Thaçit  
16 që e bën thjesht sa për diskutim. Ky është një problem, është  
17 një gjë e cila nuk është nxjerrë. A nuk do donte që ta dinte,  
18 i nderuar Gjykatës, që një ambasador i OSBE-së i cili  
19 drejtonte zyrën e OSBE-së gjatë kornizës kohore që mbulon kjo  
20 Aktakuzë është shprehur se kjo shkelje nuk është një plan i  
21 planifikuar nga udhëheqja shqiptare, që klienti im, zoti  
22 Hashim Thaçi, nuk kishte asnjë motiv për ta nxitur këtë lloj  
23 sjellje këtë lloj aktiviteti kriminal.

24 Unë me kënaqësi jua lexoj, nuk po perifrazoj, unë mund  
25 t'ua rilexoj edhe njëherë. Nuk po është se po flet Greg Kehoe

1 këtu. Ky është një informacion shfajësues. Është shumë e  
2 papranueshme që këta përfaqësues të Prokurorisë qëndrojnë aty  
3 sikur s'ka ndodhur asgjë dhe mbajnë këta njerëz në burg,  
4 ndërkohë që e kishin këtë dokumentacion i cili dukshëm hidhte  
5 dyshime mbi provat e tyre.

6 Si mund të jenë? Po për argumentet e tjera ç'mund të  
7 themi të cilat pastaj mund të shkaktojnë probleme të tjera  
8 probleme të tilla. Pastaj, kur ato thonë që dëshmitari i tyre  
9 nga i cili e morën deklaratën, ambasadori Everts e ka thënë,  
10 se nuk kishte asnjë stimul që zoti Thaçi ta bënte një gjë të  
11 tillë në bazë të marrëdhënies që ai kishte me ndërkombëtarët.  
12 Unë jua them se çfarë ka ndodhur se duket sikur është e  
13 paqartë. Është thjesht, janë thjesht rezerva që ata i kanë  
14 mbajtur. Dëshmitarët e OSBE-së janë të gjithë shfajësues dhe  
15 këto janë dorëzuar në gusht 2021. I kanë marrë miratimet për  
16 këtë. E thonë në qarkoren e tyre që miratimi është marrë në  
17 gjysmën e dytë të vitit 2021, në gusht të 2021. Pra, s'ka  
18 problem që këta të vazhdojnë që të rrinë në burg gusht,  
19 shtator, tetor, nëntor, dhjetor, janar i këtij viti. Pse nuk i  
20 kanë dorëzuar? Pse nuk na i kanë dhënë këto materiale?

21 Meqë ra fjala, ekipi i Mbrojtjes së zotit Thaçi s'ka  
22 asnjë marrëdhënie me ambasadorin Everts. Ky është një zotëri i  
23 cili ka dalë nga raportet e OSBE-së.

24 Ambasadori Prosper e mori në telefon. Kështu ndodhi. Sa i  
25 takon marrëdhënies me Mbrojtjen e Thaçit s'ka asnjë

1 marrëdhënie. Ne thjesht kemi biseduar me të si rezultat i  
2 kësaj. Dhe si rezultat i kësaj bisede të parë me ambasadorin  
3 Everts ku ai shprehu dhe befasi sesi ka mundësi që ne nuk e  
4 kishim deklaratën e tij, ai u shpreh kështu: "Do të kontaktoj  
5 njëherë ata të ZPS-së për të parë nëse mund ta marr unë  
6 deklaratën për ju".

7 Domethënë, kjo është ajo që ka ndodhur. Ne nuk jemi ne  
8 ata që e komandojmë ambasadorin Everts. Ai është një ambasador  
9 ndërkombëtar, është një personalitet, i nderuar Gjykatës.

10 Kur ka ndodhur ky kontakt që ka bërë Prokuroria për  
11 shembull? Të hënën. Ditën e hënë.

12 Një përfaqësues i Prokurorisë vetë dhe vetëm në atë  
13 moment ZPS-ja paska arritur në përfundimin që janë gjendur  
14 gafil sepse nuk e kanë nxjerrë materialin sipas rregullës 103,  
15 material i cili të paktën në rrethanat më të mira do të  
16 cenonte besueshmërinë e provave të Prokurorit të Specializuar.

17 Dhe vetëm pas kësaj, vetëm pasi ai, ambasadori Everts, e  
18 kontaktoi ZPS-në, si për mrekulli ky dokument na shfaqet  
19 përpara në mënyrë magjike se ja ne tani e morën. Këto janë  
20 gjepura. I beson njeri këto gjepura? Askush. Sigurisht, që jo.  
21 Na e dorëzuan thjesht sepse u gjendën gafil.

22 Dhe problemi, i nderuar Gjykatës, nuk është medoemos  
23 dokumenti, problemi është se ata katër njerëz janë ende në  
24 burg, ndërkohë që këta nuk na i nxjerrin dokumentet deri në  
25 momentin sa i kapin gafil. Pra, ky është problemi, i nderuar

1 Gjykatës. Është problemi që ju paraqiti ambasadori Prosper,  
2 është problem për klientin tim dhe për të gjithë të akuzuarit  
3 e tjerë.

4 Kjo Gjykatë duhet t'i lirojë këta zotërinj me çfarëdo  
5 lloj kushti që mund të vendosin, i nderuar Gjykatës, t'i  
6 lirojë sepse një anëtar i lartë i bashkësisë ndërkombëtare ka  
7 hedhur dyshime mbi gjithçka që ka përfshirë në këtë Aktakuzë  
8 ZPS-ja. Nuk mund të mbahen njerëzit në burg pa afat në bazë të  
9 kësaj.

10 Faleminderit.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zoti Kehoe.

12 Zoti Prokuror, shumë shkurt.

13 Z. KUSCHNIK: [Përkthim] Kam vetëm një pyetje të shkurtër  
14 për të sqaruar gjërat për Mbrojtjen. Ju sapo parashtruat që  
15 nuk keni asnjë marrëdhënie midis jush, pra, midis zotit Everts  
16 dhe Mbrojtjes së zotit Thaçi. Kur ju e ndani zotin Thaçi nga  
17 Mbrojtja e Thaçit, pra, nuk ka një marrëdhënie midis zotit  
18 Everts dhe zotit Thaçi, kështu thoni?

19 Z. KEHOE: [Përkthim] Mos po na akuzojnë për ndonjë  
20 shkelje këtu? Kontakti me zotin Everts ka ndodhur vetëm sepse  
21 ne deshëm që të -- në kuadër, pra, se çfarë ndodhte aso kohe.  
22 Ka një libër, faktikisht, që ka shkruar OSBE-ja dhe ka dy  
23 seksione aty. Dhe çfarë ka ndodhur? Çfarë ka ndodhur lidhur me  
24 zotin Everts? Ne s'kemi marrë asnjë udhëzim, në fakt, nga  
25 klienti ynë që të kontaktojmë ambasadorin Everts.



1 Ne pamë cila ishte lista e ambasadorëve dhe çudi e madhe,  
2 kemi dhe ne anëtarë në ekipin tonë që kanë punuar në  
3 bashkësinë ndërkombëtare dhe që është ambasadori Prosper. Dhe  
4 është ambasadori Prosper ai që kontaktoi ambasadorin Everts  
5 për t'i bërë pyetje për këtë. Ja kjo është e gjitha.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] U mbajjt shënim.

7 Z. KUSCHNIK: [Përkthim] Unë nuk po ngre asnjë pretendim  
8 dhe nuk po hedh asnjë akuzë. Ishte thjesht për të sqaruar bërë  
9 pyetje.

10 Z. KEHOE: [Përkthim] Mos e bëni më pyetjen në këtë  
11 mënyrë.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju lutem, ju lutem.

13 Z. KEHOE: [Përkthim] Kërkoj ndjesë.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zonja  
15 përkthyesë. Është një këshillë shumë e mirë. I kërkoj të  
16 gjithëve që të veprojnë kështu sipas kësaj këshille.

17 Para se të bëjmë një pushim --

18 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Përpara kësaj -- desha unë të  
19 flas.

20 Z. EMMERSON: [Përkthim] Edhe unë kam kërkuar fjalën. U bë  
21 ca kohë që e kërkoj fjalën.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Patjetër. Po mos do të  
23 fliste Prokurorja. Po jo mund t'jua jap juve me lejen e  
24 Prokurores, fjalën.

25 Z. EMMERSON: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Përfshirë

1 disa gjëra që duam që të dimë shumë qartë nga Prokuroria sesa  
2 material tjetër shfajësues ka ende në zotërim? Është me shumë  
3 rëndësi që neve këtë ta dimë, sepse ka të bëjë edhe me  
4 përgatitjen dhe ka të bëjë dhe me pikën tjetër të rendit të  
5 ditës që janë hetimet e Mbrojtjes. Nuk e dimë se dhe sa  
6 materiale të tjera do të marrim, sidomos, kur bëhet fjalë për  
7 materiale shfajësuese të cilat janë jetike për planifikimin e  
8 hetimeve të Mbrojtjes. Nuk mund të largohemi nga kjo  
9 konferencë për ecurinë e çështjes pa marrë nga Prokuroria këtë  
10 informacion sa i takon sasisë së materialit shfajësues që kanë  
11 në zotërim.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

13 Zonja Prokurore.

14 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Shumë shkurt desha që t'i  
15 përgjigjem sa i takon procesit sepse ajo që tha ekipi i  
16 Mbrojtjes së Thaçit nuk është e saktë. Paketat e rregullës 103  
17 janë përgatitur javën që shkoi në kuadër të procesit në  
18 vazhdim e sipër të shqyrtimeve të nxjerrjes.

19 Dhe sa i takon peshës së tyre, siç e tha edhe vetë zoti  
20 Kehoe, ato vendosin pikëpamjet dhe mendimet e një individi  
21 kundrejt tërësisë thelbësore të provave të tjera.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

23 Përpara se të bëjmë një pushim të shkurtër së pari  
24 dëshiroj që t'i kërkoj ZPS-së që të vazhdojë me shqyrtimin e  
25 këtij materiali dhe materiali shfajësues duhet të jetë

1 prioritet medoemos. Është thelbësore që materialet që janë me  
2 rëndësi për Mbrojtjen t'i vihen asaj në dispozicion sa më  
3 shpejt.

4 I kërkoj ZPS-ja që të informojë Mbrojtjen *inter partes*  
5 dhe pastaj edhe Gjykatësin përpara konferencës tjetër për  
6 ecurinë e çështjes mbi ecurinë e shqyrtimit të materialit që  
7 ZPS-ja ka në kontroll ose në zotërim sepse është e rëndësishme  
8 që Mbrojtja ta dijë se ku ndodhemi lidhur me këtë. Unë e di që  
9 ju thatë që 50 për qind të materialit e keni shqyrtuar. Unë  
10 nuk mendoj se i përgjigjet plotësisht pyetjes së Mbrojtjes sa  
11 i takon sasisë. Prandaj ju ftoj që t'i vazhdoni këto diskutime  
12 dhe të informoni rregullisht Mbrojtjen mbi sasinë e materialit  
13 që ende nevojitet të shqyrtohet.

14 Së fundi, vërej se Mbrojtja e Thaçit ka bërë të ditur se  
15 një mundësi është që palë e tretë ta bëjë këqyrjen e  
16 materialit për të konstatuar nëse ZPS-ja ka në zotërim  
17 material shfajësues. I kërkoj Mbrojtjes së Thaçit që të bëjë  
18 një parashtrim me shkrim të protokolluar për këtë çështje nëse  
19 dëshiron sidomos lidhur me bazën ligjore për shkak të  
20 kompleksiteteve që prefshin ky proces.

21 Z. KEHOE: [Përkthim] Patjetër.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zoti Kehoe.

23 Do bëjmë një pauzë të shkurtër. Është ora 16.26. Duke  
24 pasur parasysh që kemi në dispozicion deri në orën 18.00  
25 maksimumi, kështu që do të rifillojmë në orën 16.50 minuta me

1 orën e Hagës.

2 Këtu ndërpritet seanca.

3 --- Pauza fillon në orën 16.27

4 --- Seanca rifillon në orën 16.51

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Le të kalojmë në kategorinë  
6 e fundit për nxjerrjen e materialeve që janë materialet nën  
7 rregullën 107. Vërej që në parashtrimet e veta ZPS-ja thotë që  
8 po vazhdon në mënyrë aktive që të përfundojë diskutimet lidhur  
9 me ofruesit e materialeve nën rregullën 107. ZPS-ja ka thënë  
10 që dy parashtrimet të protokolluara do të dorëzohen pasi të  
11 kenë përfunduar diskutimet paraprake me ofruesit e shërbimit  
12 në lidhje me masat kompensuese të propozuara për sa i takon  
13 parashtrimeve përkatëse.

14 Dua të ftoj ZPS-në që të bëjë parashtrimet e veta lidhur  
15 me këtë temë.

16 Zonja Prokurore, fjala për ju.

17 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Ne po punojmë që të përfundojmë  
18 diskutimet me ofruesit për dokumentet që bien nën rregullën  
19 107. Ne vazhdojmë që të jemi në kontakt disa herë në javë me  
20 shumë prej tyre dhe shpesh herë shikojmë me ta dokumente  
21 specifike individuale me hollësi dhe si rezultat i këtyre  
22 përpjekjeve, është bërë progres i konsiderueshëm. Dhe për  
23 pjesën më të madhe, vendimi dhe afati kohor i përcaktuar në  
24 vendim, është arritur.

25 Ndërkohë, siç e thamë sot paradite, kemi parashtruar një

1 dokument të një parashtrimi të protokolluar 687 lidhur me 21  
2 dokumentet për të cilët janë dhënë leje nga dy ofrues.  
3 Ndërkohë ka edhe kërkesa të tjera të cilat lidhen me  
4 dokumentet që bien nën rregullën 107(2) dhe për të cilat ne po  
5 diskutojmë me ofruesit lidhur me masat kompensuese të  
6 propozuara.

7 Parashtrimi që ne kemi dorëzuar dje, po ashtu përmban një  
8 vështrim të përgjithshëm të ofrueseve të shërbimit dhe nuk na  
9 kanë mbetur edhe shumë dokumente të tjera të cilët do të duhet  
10 që të nxirren. Ne presim që të përfundojmë një pjesë të mirë  
11 të këtyre diskutimeve në javët në vijim.

12 Në qoftë se do të kemi nevojë për aplikime të tjera,  
13 atëherë do të bëjmë aplikimet sipas nevojës, në kojen e  
14 nevojshme.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

16 Ekipet e Mbrojtjeve duan që të marrin fjalën lidhur me  
17 këtë aspekt?

18 Z. Kehoe.

19 Z. KEHOE: [Përkthim] Jo, nuk kemi asgjë për të shtuar  
20 lidhur me këtë.

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Shikoj që nuk është se  
22 dëshiron ndonjë ekip tjetër i Mbrojtjes për të thënë gjë  
23 lidhur me këtë temë.

24 Atëherë do kalojmë në temën tjetër në rendin e ditës për  
25 sot, që është çështja e përkthimeve. Do të doja që së pari t'i

1 jap fjalën Zyrës së Administrimit lidhur me progresin që është  
2 bërë në punën për përkthimin e këtyre dokumenteve.

3 Përkatësisht do të doja të dija në qoftë se palët kanë  
4 bërë ndonjë kërkesë urgjente të mëtejshme për përkthime dhe në  
5 qoftë se Zyra e Administrimit mund të japë një vlerësim të  
6 përgjithshëm lidhur me përkthimin e dosjes para-gjyqësore të  
7 ZPS-së dhe materialet lidhur me të dhe dokumentet në tabelë në  
8 rregullën 109(c).

9 Dua t'i kërkoj palëve në qoftë se kanë vështirësi të  
10 tjera lidhur me përkthimin dhe në qoftë se ka ndonjë  
11 parashtrim lidhur me këtë dhe përparësimin e dokumenteve që  
12 duhen përkthyer.

13 Z. NILSSON: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

14 Siç e kemi përcaktuar edhe në parashtrimet me shkrim,  
15 puna për përkthimin e dosjes para-gjyqësore është në drejtimin  
16 e duhur dhe e kam fjalën këtu si për dokumentin e redaktuar,  
17 për përkthimin rreptësishtë konfidencial dhe konfidencial, që  
18 do të përfundojë deri me 18 shkurt. Në të njëjtën kohë, do të  
19 kemi përfunduar gjithashtu edhe përkthimin e parashikuar të  
20 listave të dëshmitarëve. Nuk kemi kërkesa të tjera për  
21 përparësi përkthimi me njësinë e përkthimit.

22 Sa i takon tabelës sipas rregullit 109(c), ne i kemi  
23 thënë sfidat dhe vështirësitë që i kemi lidhur me këto  
24 dokumente, i kemi parashtruar ato në parashtrimet me shkrim që  
25 ju kemi dorëzuar. Nuk dua që të përsëris atë çfarë kemi

1 shkruar, megjithatë do të thosha që në qoftë se do të kemi  
2 ndonjë kërkesë për përparësi për përkthimin e këtyre  
3 dokumenteve, ne do të mundohemi që palët të jenë sa më  
4 konkrete të jetë e mundur lidhur me faqet dhe me pjesët  
5 përkatëse të cilat kanë më shumë rëndësi për ta. Pra do na  
6 ndihmonin shumë në qoftë se do jenë sa më konkretë të jetë e  
7 mundur dhe do të mundohemi që t'i përgjigjemi kërkesës së  
8 palëve. Domethënë në qoftë se kanë palët ndonjë kërkesë për  
9 përparësinë në përkthim, ju lutem të jeni sa më konkretë të  
10 jetë e mundur.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, Z. Nilsson.  
12 Z. Kehoe?

13 Z. KEHOE: [Përkthim] Nuk kemi asgjë për të shtuar. E  
14 kuptojmë pozitën e Zyrës së Administrimit dhe në qoftë se do  
15 të kemi kërkesa për përcaktim përparësie të përkthimeve, do  
16 t'i bëjmë këto kërkesa në kohën e duhur.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Emmerson?

18 Z. EMMERSON: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Nuk e di në  
19 qoftë se kolegët e mi kanë ndonjë gjë për të shtuar. Në të  
20 kundërtën, unë nuk kam gjë për të shtuar lidhur me këtë pikë.

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

22 Z. Young, ju lutem?

23 Z. YOUNG: [Përkthim] Nuk kam gjë për të shtuar.

24 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, Z. Young.

25 Z. Ellis?

1 Z. ELLIS: [Përkthim] Ne e konsiderojmë tabelën sipas  
2 rregullës 109(c) si përparësi dhe do të dorëzojmë kërkesën për  
3 Zyrën e Administrimit. Zoti Krasniqi dëshiron që ta shikojë  
4 këtë dokument të gjithin. Megjithatë, do ta shqyrtojmë edhe  
5 një herë këtë pozicion tëndin.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

7 Z. Laws, dëshironi të nxirrni ndonjë çështje për diskutim  
8 lidhur me këtë temë?

9 Z. LAWS: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Jo,  
10 faleminderit, të nderuar Gjykatës.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Tani le t'i kthehemi sërish  
12 ZPS-së të na thonë lidhur me gjendjen e hetimeve në vazhdim.  
13 Që prej konferencës së fundit, ZPS-ja ka parashtruar dosjen  
14 paraprake dhe materialet të lidhur me të, në pajtim me  
15 Rregullën 95.

16 Gjithashtu, ka depozituar edhe tabelën sipas rregullës  
17 109(c) me 28 janar, të vitit 2022.

18 Në parashtrimet me shkrim ZPS-ja thotë që hetimet e ZPS-  
19 së për të realizuar mandatin e saj parashikohen të vijojnë për  
20 të ardhmen e parashikueshme.

21 Tani dua që të insistoje në faktin që baza faktike e  
22 çështjes së ZPS-së duhet të dërgohet për gjykim dhe hetimet e  
23 ZPS-së duhet që të kenë përfunduar në pjesën dërrmuese të  
24 tyre, përpara se çështja t'i transmetohet Trupit Gjykses.  
25 Hetimet e përgjithshme nuk duhet që të vazhdojnë deri në fund



1 të gjykimit. Është e nevojshme që të kemi një çështje të  
2 depozituar që i është transmetuar siç duhet Trupit Gjykses.

3 Rregulla 102(4) e konfirmon këtë objektiv. Vetëm në  
4 rrethana përjashtimore mund të nxirren prova shtesë dhe më pas  
5 të mund të përdoren në procesin e gjykimit. Mbrojtja nuk mund  
6 të pritët që të përgatisë një mbrojtje për një çështje e cila  
7 është gjithmonë në evoluim e sipër.

8 Dua t'i kërkoj ZPS-së të na thotë në qoftë se mund të na  
9 japë një përditësim tjetër të mëtejshëm për datën e vlerësuar  
10 për sa i takon përfundimit të hapave hetuese në vijim e sipër  
11 dhe natyrës së hetimeve. Gjithashtu dua të ftoj Mbrojtjet që  
12 të paraqesin pikëpamjet e tyre lidhur me këtë temë.

13 Zonja Prokurore, fjala për ju.

14 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, më lejoni të  
15 them që ne jemi të ndërgjegjshëm për kuadrin e përgjithshëm.  
16 Megjithatë nuk kam shumë për të shtuar se sa parashtrimet që  
17 kam dhënë në konferencat e mëparshme. Ne do të vazhdojmë që të  
18 hetojmë në përputhje me mandatin tonë dhe në qoftë se hetime  
19 të tilla do të çojnë në materiale ku do të mbështetemi ose në  
20 qoftë se kërkojnë autorizim gjyqësor ose në qoftë se  
21 materialet janë shfajësuese, padyshim që do t'ja vëmë në  
22 dispozicion Mbrojtjes edhe do të përmbushim të gjitha  
23 detyrimet për nxjerrje informacioni.

24 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

25 Z. Kehoe?

1           Z. KEHOE: [Përkthim] Në përputhje për përfundimin e -- në  
2 përputhje me urdhrin dhe me deklaratën që sapo dhatë, i  
3 nderuar Gjykatës, për përfundimin e hetimit, dua që të kujtoj  
4 parashikimin sipas rregullës 47, për të përfunduar hetimet.  
5 Dhe ligji i Kosovës lejon hetimet vetëm për një periudhë të  
6 caktuar dhe kështu që do të dua që ta sjell edhe një herë në  
7 vëmendjen e të gjithëve këtë gjë. Parashtrimin me shkrim  
8 lidhur me Rregullën 47 do ta bëj më vonë.

9           GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Kehoe.

10          Z. Emerson?

11          Z. EMMERSON: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Së pari, më  
12 lejo t'ju falënderoj për udhëzimet që dhatë, i nderuar  
13 Gjykatës, gjë e cila, të paktën jep ca siguri që do i vij  
14 fundi i këtij ushtrimi. Megjithatë, me lejoni të them që e  
15 gjithë kjo ka ndikim mbi hetimet e Mbrojtjes dhe ka ndijim  
16 gjithashtu edhe për çështjen e referimit përpara Trupit  
17 Gjykues kurdo që të ndodhë kjo. Ky proces ka nevojë që të  
18 bëhet transmetimi i të gjithë dosjes së çështjes dhe secila  
19 prej pikave të akuzës të mund të shpjegohet në detaje. Më  
20 lejoni të them diçka më tepër lidhur me atë se çfarë pamje do  
21 të ketë dosja e çështjes dhe kush e ka përgjegjësinë për  
22 përmbajtjen e saj.

23          GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Emerson.

24          Z. Young, fjala për ju.

25          Z. YOUNG: [Përkthim] Nuk kam asgjë për të shtuar. I

1 nderuar Gjykatës, besoj se e mbani mend në konferencën e parë  
2 për Ecurinë e Çështjes unë përdora fjalën "gijotinë". Është  
3 një fjalë franceze dhe ka të bëjë me datën e ekzekutimit.

4 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

5 Z. Ellis?

6 Z. ELLIS: [Përkthim] Jemi plotësisht dakord, dhe me thënë  
7 të drejtën jemi dakord me atë çfarë thatë ju, i nderuar  
8 Gjykatës, sepse hetimet e Prokurorisë nuk mund të vazhdojnë  
9 gjatë gjithë procesit gjyqësor për këtë çështje.

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

11 Zonja Prokurore, keni ndonjë gjë për t'u përgjigjur  
12 lidhur atë çfarë thamë deri tani?

13 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Jo, nuk kam asgjë për të shtuar.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Më lejoni të theksoj se ne  
15 keni një kuadër ligjor dhe provat shtesë do të pranohen vetëm  
16 me një kontroll shumë rreptësor nga Trupi Gjykses dhe do të  
17 duhet që të jenë të qarta në procesverbal.

18 Tani më lejoni të kalojmë në pikën tjetër të agjendës, që  
19 janë hetimet e Mbrojtjes.

20 Pasi i kemi marrë dosjen paraprake dhe tabelën sipas  
21 Rregullës 109(c) si dhe pjesën më të madhe të materialeve në  
22 Rregullën 102(b), jam i interesuar të dëgjoj pozicionin e  
23 Mbrojtjes lidhur me gjendjen e hetimeve të tyre. Në veçanti do  
24 të dua që Mbrojtjet të më thonë në qoftë se mbrojtjet kanë  
25 ndonjë ide apo kanë plane për të thënë informacion për sa i

1 takon gjendjes së hetimeve të tyre ose në qoftë se ata kanë  
2 synim të bëjnë kërkesa lidhur me mundësitë unike hetuese dhe  
3 në qoftë se Mbrojtjet mund të japin një informacion lidhur me  
4 synimin e tyre për njoftim për alibi ose shkaqe për  
5 përgjegjësi përjashtimore. Pra edhe në qoftë se Mbrojtja nuk  
6 është në pozicion që të japë detaje sa i takon hetimeve dhe  
7 kërkesave në vijim, dua t'i kërkoj Mbrojtjes që të japin një  
8 vlerësim të përgjithshëm të kohëzgjatjes së pritshme të  
9 hetimeve të tyre dhe të na thonë se kur mendojnë se do të jenë  
10 në pozicion që të parashtrojnë dosjen paraprake dhe materialin  
11 e lidhur.

12 I kërkoj Mbrojtjes gjithashtu, që të thonë në qoftë se  
13 nuk dëshirojnë që të parashtrojnë dosjen paraprake në  
14 përputhje me rregullën 95(5).

15 Z. Kehoe?

16 Z. KEHOE: [Përkthim] Juve sapo përmendët disa prej  
17 problemeve të cilat kanë të bëjnë me këtë hetim dhe njëra prej  
18 tyre është edhe pandemia e kovidit. Megjithatë, duke marrë  
19 parasysh materialet e shumta që kemi marrë gjatë muajve të  
20 fundit, përfshirë këtu edhe materialin shumë voluminoz të  
21 marrë në 31 janar. Pra, thamë gjithashtu që ka mbi 326  
22 dëshmitarë, 106 janë anonimë, nuk e dimë se kush janë këta  
23 dëshmitarë dhe mund të marrim identitetin e këtyre personave  
24 në mes të hetimeve, në mes të procesit gjyqësor ose më tej.

25 Megjithatë, ne nuk është se po ju themi që nuk jemi në

1 terren duke bërë hetimet. Jemi në terren duke bërë hetimet,  
2 por po mundohemi them që koha që na duhet për hetimet është  
3 shumë herë më e madhe dhe në qoftë se do të kishim më shumë  
4 informacion sa i takon akuzave, ne do të kishim mundësi që  
5 mund të kalonim shumë më tepër procedura dhe hapa të caktuara  
6 të hetimit. Por shpesh herë gjendemi në një pozicion se na  
7 duhet të marrim me mend se për çfarë po flet Prokuroria dhe ky  
8 është një proces i cili kërkon vërtetë kohë. Kërkon kohë sa i  
9 takon dosjes paragjyqësore lidhur me informacionin e shumtë që  
10 na është parashtruar në tabelën 109(c).

11 Ndërkohë që në qoftë se më kërkoni se sa kohë do më duhet  
12 mua për të bërë këto hetime, këtë gjë nuk e bëj dot. Më duhet  
13 që ta mendoj për konferencën e ardhshme dhe ju jap fjalën që  
14 do flasim në detaje me ekipin e hetimit, do të diskutojmë me  
15 ta. Mendoj që koha që do ju duhej atyre është goxha e gjatë,  
16 megjithatë nuk dua që të flas sot dhe nuk dua t'ju jap një  
17 përgjigje përfundimtare lidhur me kohën që do të na duhet për  
18 të përfunduar hetimet.

19 Sa i takon çështjes që ka të bëjë me Rregullën 109(c),  
20 marrjen e deklaratave të dëshmitarëve, ne jemi në proces e  
21 sipër, duke e bërë këtë gjë dhe besoj që dokumentacioni  
22 përkatës do ju vihet në dispozicion juve ose Trupit Gjykses  
23 prej tre gjykatësish. Pra duke qenë që Prokuroria kërkon 1800  
24 e ca orë sa i takon trajtimit dhe kohës që i duhet për  
25 procesin gjyqësor.

1 Por disa nga këta individë nuk është se janë kaq të rinj,  
2 me gjithë respektin për ta dhe kur them që nuk janë kaq të  
3 rinj, e kam fjalën që janë të moshuar. Kështu që do të duhet  
4 të merren disa vendime në të ardhmen e afërt lidhur me disa  
5 prej këtyre dëshmitarëve, të cilët kanë një farë moshe. U uroj  
6 jetë sa më të gjatë, megjithatë aspektet praktike janë të  
7 tilla që në qoftë se ky proces gjyqësor do të vazhdojë dhe  
8 duket se do të vazhdojë për vite, do të duhet që të merren  
9 disa masa në mënyrë që të dëgjohen të gjithë dëshmitarët.

10 Atëherë nuk është se kam një përgjigje përfundimtare,  
11 megjithatë po ju the kaq gjë: tani për momentin sa i takon  
12 alibisë, kur i kthehem sërish informacioni të redaktuar,  
13 gjithë informacion që është në aktpadi ne nuk e dimë akoma.  
14 Ajo çfarë mund t'ju themi, i nderuar gjykatës tani është që  
15 klienti im, zoti Thaçi, ka qenë jashtë vendi në periudhën  
16 1998-1999 për periudha goxha të konsiderueshme kohe dhe  
17 megjithëse nuk kemi data, mendoj që ne do të duhet që të  
18 shikojmë pak në më tepër detaje, informacionet. Kur të kemi  
19 pak më shumë informacion nga prokuroria, mendoj që -- jam i  
20 sigurt që do të mund të mund të ngremë elementin e alibisë për  
21 elementë të caktuar, informacione të caktuara të cilat do të  
22 na jepen nga Prokuroria.

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

24 Z. Emerson?

25 Z. EMMERSON: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Do t'i

1 kërkoj Z. Strong që të japë parashtrimet lidhur me hetimet e  
2 Mbrojtjes. Ai është me Kujtim Kerveshin po ashtu në Gjykatë,  
3 që është shefi i hetimeve në Kosovë.

4 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Emmerson.

5 Z. Strong, fjala për ju.

6 Z. STRONG: [Përkthim] Faleminderit.

7 Mbrojtja e Veselit e ka nisur procesin e vet të hetimit  
8 dhe siç e kemi thënë edhe në konferencat e mëparshme për  
9 ecurinë e çështjes, ne kemi të njëjtat problemet të cilat i  
10 përmendi edhe kolegu im, z. Kehoe pak më parë.

11 Mendoj se ajo çfarë është më e rëndësishme është që  
12 hetimet po fillojnë gradualisht me hope dhe për ne -- ne kemi  
13 për shembull, marrim një dokumentacion, nxjerrim informacionin  
14 që ka me mijëra dokumente, me 2000 dokumente, për shembull, e  
15 marrim këtë dokumentacion dhe pastaj na duhet që pastaj të  
16 ndalojmë për një moment deri sa të marrim pjesën tjetër të  
17 informacionit. Dhe siç e dini, të nderuar Gjykatës, së bashku  
18 me dosjen paraprake, kemi rreth 16 mijë dokumente, të cilat do  
19 të duhet të shqyrtohen. Sa i takon rregullës 103, ne siç e  
20 dimë, presim ende nga Prokuroria një pjesë të dokumentacionit  
21 që nuk është rishikuar prej tyre, kështu që ne na duhet një  
22 lloj afati, një lloj vlerësimi, për të ditur se kur do ta  
23 marrim këtë informacion, sepse ky informacion do të ketë  
24 ndikim mbi hetimet tona apo mbi strategjinë e Mbrojtjes.

25 Ne do të bëjmë sa më shumë të mundemi për të pasur hetime

1 të shpejta, por duke pasur parasysh këtë realitet, është e  
2 vështirë për ne për të dhënë një datë të përafërt, një afat se  
3 kur mund të presim se do të përfundojnë hetimet.

4 Aktualisht nuk shikojmë nevojën për një mundësi të  
5 posaçme hetimore, megjithatë kjo situatë mund të ndryshojë në  
6 qoftë se dalin elementë të rinj. Sa i takon çështjeve të  
7 tjera, mendoj se mund t'i përfshijmë në një parashtrim dhe  
8 mund të themi që kur të shohim më shumë materiale në rregullin  
9 103 dhe kur të shohim më tepër dokumentet nga volumi i  
10 përgjithshëm i dokumentacionit që na është dhënë nga  
11 Prokuroria, atëherë do të kemi mundësinë që t'ju japim më  
12 shumë informacion konkret.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Emmerson.

14 Z. EMMERSON: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Më lejoni  
15 ju lutem që të ngre një pikë. Ju na kërkuat ne që të bëjnë më  
16 të mirën në mënyrë që të t'ju japim një kohë të përafërt se  
17 kohë do të na marrë hetimi. Dhe pa diskutim që ne jemi të  
18 gatshëm që ta bëjmë këtë gjë sa më shpejtë që të jetë e  
19 mundur.

20 Por nga ana tjetër, në qoftë se do të merrni parasysh  
21 çështjen që e ngritët pak më parë lidhur me protokollet e  
22 dëshmitarëve, pra me fjalë të tjera, parashtrimet e shkruara  
23 të cilat janë ndjekur në seancën orale me datë 22 dhe ndërkohë  
24 ky është një proces i cili do të ketë një ndikim të  
25 jashtëzakonshëm mbi kohën se sa do të na duhet ne për të bërë



1 hetimet. Jam i sigurt që ju e njihni procesin, procesi që  
2 parashikohet nga protokolli, që na kërkon neve t'i shkruajmë  
3 Prokurorisë. Prokuroria pastaj i shkruan dëshmitarit, t'i  
4 marrë atyre mendimin në qoftë se kanë ndonjë kundërshtim apo  
5 jo, pastaj të bëjë një vlerësim dhe në qoftë se e shikon të  
6 përshtatshëm, të organizojë një udhëtim ku dëshmitari do të  
7 duhet të paguajë vetë për rrugën për në Hagë dhe që do të  
8 takohet me neve në praninë e Prokurorisë.

9 Kjo është një mangësi e jashtëzakonshme për të gjitha  
10 Mbrojtjet, unë nuk kam dëgjuar për asgjë të krahasueshme me të.  
11 Pra, vetëm prezumimi që kjo është qasja që do të merret,  
12 domethënë, është një barrë e jashtëzakonshme për neve. Pra  
13 Prokuroria i ka intervistuar të gjithë këta personat, dhe  
14 pastaj do të marri vendimin se kush nga këta persona do të  
15 ulet së bashku me ne. Por Mbrojtja duhet që të ketë vlerësimin  
16 e vet, por kjo ka ndikim mbi procesin e rregullt dhe në qoftë  
17 se Prokuroria do të jetë pjesë e një çështjeje të mbrojtjes  
18 dhe sigurisht që mund të bëhen edhe ndryshime. Domethënë në  
19 qoftë se ka shqetësime faktike për dëshmitarët. Megjithatë,  
20 ajo çfarë po mundohem të them është që hetimi mund të marrë 9  
21 muaj ose 12 muaj në qoftë se nuk do të kishim argumente të  
22 tilla. Por në këtë situatë do të na duhet ndoshta dy ditë e  
23 gjysmë hetime, domethënë pa diskutim që kjo ka ndikim të  
24 jashtëzakonshëm mbi periudhën para gjykimit.

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Emmerson.

1 Z. Young?

2 Z. YOUNG: [Përkthim] Shkurtimisht, më lejoni të them që  
3 sa i takon hetimeve të Mbrojtjes, siç e thash edhe në  
4 Konferencën e mëparshme, ne i kemi filluar hetime dhe  
5 sigurisht që procesi në vetvete do të jetë një proces që  
6 kërkon kohë, do të jetë i shtrirë në kohë, kështu që është e  
7 pamundur për neve për të thënë se sa kohë do të na duhet për  
8 të bërë hetimet e mbrojtjes. Në veçanti, duke pasur parasysh  
9 edhe çfarë përmendëm edhe pak më përpara.

10 Pra kemi një material shumë voluminoz për të shqyrtuar  
11 dhe për të përtypur. Ne po lexojmë dosjen paragjyqësore dhe  
12 dokumente të tjera. Është një proces i cili do të na marrë  
13 goxha muaj. Ndërkohë që sa i takon nxjerrjes së materialeve në  
14 përgjithësi, siç e dini, i nderuar Gjykatës, ka ende një sasi  
15 të jashtëzakonshme informacion që ende nuk e kemi në  
16 dispozicionin tonë. Në qoftë se do të na jepen materialet nën  
17 rregullën 102(3), bëhet fjalë për 143 mijë materiale të tjerë  
18 që do duhet që t'i lexojmë. Kështu kjo është për të thënë, që  
19 pavarësisht interesit tonë për ta kaluar këtë proces sa më  
20 shpejtë të jetë e mundur, është e pamundur që t'ju japim një  
21 kohë gjatë të cilës ne do të mund të përmbylлим hetimet tona.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit. Young.

23 Znj. Alagendra?

24 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, hetimet  
25 tona kanë filluar. Janë në vijim e sipër, por është shumë

1 herët për neve për të dhënë një vlerësim se sa kohë do të na  
2 duhet për t'i përfunduar ato dhe kur do të jemi në gjendje që  
3 të parashtrojmë dosjen tonë para gjyqësore.

4 Ne kemi të njëjtin pozicion, si pozicionet e Mbrojtjeve  
5 të ekipeve të tjera, kështu që për këtë arsye është e pamundur  
6 që të japim një vlerësim të përafërt në këtë pikë. Ndoshta në  
7 konferencën e radhës për ecurinë e çështjes do të kemi mundësi  
8 që të japim një kohë më të përshtatshme.

9 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Do t'u kërkoja ekipeve të  
10 Mbrojtjeve që të jepnin një vlerësim, vlerësimin më të mirë të  
11 mundur të tyre në konferencën e ardhshme për ecurinë e  
12 çështjes, siç u sugjerua edhe nga z. Kehoe.

13 Zonja Prokurore, dëshironi të thoni diçka lidhur me këtë  
14 pikë?

15 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Neve i kemi dhënë Mbrojtjes një  
16 listë prej 300 fakteve të propozuara të rëna dakord në mars të  
17 vitit 2021. Duke përjashtuar përkthimet, ne kemi nxjerrë rreth  
18 95% të materialeve, sipas rregullës 102(1)(b) rreth pesë  
19 muajve më përpara dhe kjo ka ndodhur saktësisht me datë 18  
20 gusht. Të gjitha këto janë nënkategorizuar në sistemin *Legal*  
21 *Workflow*. Ne kemi dhënë gjithashtu një listë të dëshmitarëve  
22 paraprakë, përfshirë këtu edhe përmbledhjet, në tetor të vitit  
23 2021, dhe kemi parashtuar edhe dosjen paragjyqësore, listën e  
24 provave materiale dhe të dëshmitarëve në dhjetor të vitit  
25 2021.

1 Në qoftë se ka ndonjë gjë që mund të bëjmë për të  
2 ndihmuar ekipet e Mbrojtjes, ju lutem na e thoni këtë gjë.

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

4 Z. Emmerson?

5 Z. EMMERSON: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Siç e  
6 thashë edhe më përpara, ju kërkoj ndjesë, kam një çështje të  
7 rëndësishme që dua të ngre me ju. Faleminderit.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Mirë atëherë, mos u  
9 shqetësoni, pa diskutim që do jua jap fjalën por këtë do ta  
10 bëj pasi të kem propozuar datën për konferencën e ardhshme të  
11 ecurisë së çështjes. Dua t'ju kërkoj që të konfirmoni datën e  
12 propozuar për Konferencën e ardhshme që është e enjte, data 24  
13 mars, i vitit 2022, në orën 14.30 koha e Hagës.

14 Zonja Prokurore?

15 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës, jemi të  
16 disponueshëm.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

18 z. Kehoe?

19 Z. KEHOE: [Përkthim] Po, edhe ne jemi të disponueshëm.

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Emmerson?

21 Z. EMMERSON: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Po, edhe  
22 neve.

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Young?

24 Z. YOUNG: [Përkthim] Po.

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Znj. Alagendra?

1 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Po, ne jemi të disponueshëm si  
2 me 24 mars, ashtu edhe me datën 22 shkurt.

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

4 Z. Laws?

5 Z. LAWS: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Po jemi të  
6 disponueshëm edhe ne. Faleminderit.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit juve, Z. Laws.

8 Z. Nilsson?

9 Z. NILSSON: [Përkthim] Faleminderit që na pyetët, i  
10 nderuar Gjykatës, pa diskutim që jemi të disponueshëm.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Pa diskutim, ju jeni  
12 përgjegjës për administrimin e proceseve gjyqësore. Në qoftë  
13 se nuk jeni ju të disponueshëm, i takon që s'mund të kemi  
14 seancë as neve.

15 Atëherë, si zakonisht do të merrni një urdhër për  
16 përcaktimin e datës, si zakonisht.

17 Në këtë pikët, dua që t'ju kërkoj palëve të na thonë nëse  
18 kanë ndonjë shqetësim tjetër që duan ta ngrenë.

19 z. Emmerson na tha pak më përpara që dëshiron të ngrejë  
20 një çështje konkrete, por përpara se t'i jap fjalën zotit  
21 Emmerson, le të kalojmë sipas rendit të zakonshëm.

22 Zonja Prokurore?

23 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Jo, s'kam asgjë për të thënë.

24 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

25 Z. Kehoe?

1 Z. KEHOE: [Përkthim] Vetëm dy pikat që unë i ngrita pak  
2 më përpara për çështjen e mbajtjes në paraburgim dhe seancën e  
3 datës 22 shkurt. Sigurisht që gjëja më e rëndësishme është  
4 udhëzimi prej jush, i nderuar gjykatës, për sa i takon lirit  
5 para procesi gjyqësor.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Emmerson?

7 Z. EMMERSON: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Ju jam  
8 mirënjohës që më dhatë kohë të mjaftueshme për të trajtuar  
9 këtë çështje. Është e rëndësishme tani që kemi dosjen  
10 paraprake të Prokurorisë dhe siç është thënë, kjo na ndihmon  
11 që të krijojmë një ide për çështjen. Ka ende shumë gjëra që  
12 mungojnë por janë nxjerrë mjaftueshëm materiale për të më  
13 mundësuar që të bëjmë një analizë të situatës dhe të bëj disa  
14 parashtrime të përgjithshme lidhur me objektin dhe shkallën e  
15 provave të paraqitura nga Prokuroria. Ju kujtohet nga një  
16 seancë e mëparshme, e kam ngritur më shumë se një herë dhe e  
17 kam parashikuar që po shkojmë drejt një gjyqi të  
18 pamenaxhueshëm dhe se duhej gjetur një zgjidhje, sigurisht që  
19 është përgjegjësia juaj që të imponoheni Prokurorisë apo  
20 përgjegjësinë e Trupit Gjyqësor.

21 Gjithsesi, për shkak se Tribunali po ndjek një rrugë, të  
22 themi, për herë të parë, po mësohet edhe si të thuash përvoja,  
23 kurse në TPNJ, Trupi Gjyqësor vendoste një kufi në numrin e  
24 orëve dhe do të kërkonte një afat të përgjithshëm sipas të  
25 cilit asnjë dëshmitar të mos zgjaste më shumë se gjysmë ore,

1 përveç se kur pala që do ta merrte në pyetje do t'i bënte një  
2 kërkesë gjyqtarit.

3 Pra mund të bëhen shumë gjëra për të ruajtur një farë  
4 kontrolli në ecurinë e çështjeve. Si për shembull, në gjyqin e  
5 Millosheviçit, ai vdiq, sepse gjyqi vazhdoi shumë. Në atë  
6 rast, Prokuroria kishte vendosur që të trajtonte të gjithë  
7 krimet e pretenduara të Millosheviçit lidhur me Kroacinë,  
8 Bosnjën dhe Kosovën, me një gjyq të përbashkët.

9 Me këtë prezantim dhe besoj që parashtrimet e mia do të  
10 thonë që nuk jemi në TPNJ këtu, sepse ky është paraqitur si  
11 argument kur diskutuam në qershor të vitit 2020, unë ju  
12 tërhoqa vëmendjen ndaj afatit që ka kërkuar procedura  
13 paragjyqësore dhe e kam krahasuar me TPNJ-në dhe GJPNJ-në dhe  
14 e parashikova që do të vijmë në fund të vitit dhe nuk do të  
15 ishim të gatshëm për të filluar gjyqin. Bazuar në një analizë  
16 të kujdesshme të praktikave dhe të kohës që kanë kërkuar  
17 çështjet e tjera, tani kemi kaluar periudhën paragjyqësore dhe  
18 shqetësimi që kam unë është që të akuzuarve u është mohuar  
19 lirimi i parakohshëm, në bazë të paraqitjes jo të vërtetë të  
20 fazës paragjyqësore.

21 Unë ju ftoj juve dhe Prokurorinë që të mos bëni të  
22 njëjtin gabim sepse nuk mohohet që Prokuroria nuk ka mundur ta  
23 zotërojë siç duhet çështjen e saj. Një pjesë e këtyre pasojave  
24 është se nuk ka prova të drejtpërdrejta për krimet që  
25 pretendohet se janë kryer nga asnjëri prej të akuzuarve.

1 Gjithçka është mbështetur në ngjarje ku asnjë prej të  
2 akuzuarve nuk janë përfshirë.

3 Dhe kjo e bën çështjen edhe më të vështirë për  
4 Prokurorinë për të ecur përpara, prandaj tendenca është që të  
5 fusin gjithçka, si të thuash, e fusim në lavaman gjithë enët  
6 bashkë. Rezultati i këtij procesi dhe ta shikojmë për një  
7 moment, është që Prokuroria ka dhënë vlerësimet e saja për  
8 kohën që i kërkohet për dëshmitarët që ajo do të thërresë, por  
9 këto vlerësime kërkojnë më shumë se 1300 orë, vetëm për  
10 pyetjet e drejtpërdrejta të Prokurorisë. Ta shohim këtë në  
11 perspektivë. Në rastin e Millosheviçit, Prokuroria përdori  
12 gjithsej 360 orë për të paraqitur provat e çështjes së saj, që  
13 përfshinte edhe pyetjet e bëra nga Mbrojtja.

14 Në rastin tonë, Prokuroria kërkon 1300 vetëm për pyetjet  
15 e bëra prej palës thirrëse, në rastin e kësaj Prokurorie. Në  
16 rastin e Millosheviçit u përdorën 360 orë për pyetjet e  
17 drejtpërdrejta dhe e tërë çështja zgjati dy vite. Dhe kështu  
18 ka qenë. Pra në fillim ishin 1300 orë për Prokurorinë, pastaj  
19 360 orë për Millosheviçin dhe në atë rasti, ai vdiq. Në  
20 çështjen e Prliçit, Prokuroria përdori më pak, 296 orë, për të  
21 paraqitur çështjen, për një kohë afërsisht një vit e 9 muaj.  
22 Dhe një nga çështjet që ishte më e mirë, për sa i takon kohës,  
23 ishte ajo e krimeve të kryera në Kosovë nga pesë ushtarakë  
24 serbë, për krime kundër njerëzimit. Ishte operacioni në bazë  
25 të të cilit Serbia e përzuri të gjithë popullsinë shqiptare



1 nga Kosova, pas bombardimeve të NATO-s dhe e detyroi  
2 popullsinë civile të shkonte në Shqipëri apo në Maqedoni,  
3 Malin e Zi dhe në Shqipëri.

4 Pra një gjyq shumë i rëndësishëm në të njëjtin territor  
5 për të cilin po flasim këtu, dhe çështja e Milutoniviçit apo  
6 Shainoviçit, ku Prokuroria përdori 166 orë, një të dhjetën e  
7 kohës që kërkon këtu Prokuroria, afërsisht dhjetë muaj dhe  
8 ishin çështje mjaft të mëdha.

9 Po në këto tre çështje ka një model interesant, pra një  
10 mënyrë e menaxhuar shumë mirë e kohës në TPNJ. Pra një model  
11 përgjithësisht mjaft konsekuent për sa i takon numrit të  
12 dëshmitarëve, numrit të orëve për pyetjet.

13 Me këtë ritëm, po ta përdorim atë këtu, te dëshmitarët e  
14 Prokurorisë të paraqitur në këtë çështje, do të zgjaste diçka  
15 rreth 120 muaj, që do të zgjaste 11 vite.

16 Pra minimumi do të ishte pra, dy vite, po flasim për një  
17 gjyq që do të vazhdonte 14-15 vite.

18 Përveç dëshmitarëve që kanë ata në listë, Prokuroria ka  
19 propozuar edhe 16.000 prova materiale dhe numri i përgjithshëm  
20 i dëshmitarëve është pra 345. Pra këto janë shifrat që ju  
21 dhashë juve për dëshmitarët që do të thirren drejtpërdrejtë.  
22 Pra, Prokuroria duhet të jetë në gjendje të shtrëngojë rripin  
23 dhe të provojë çështjen e saj, sepse po u lejua me këto shifra  
24 që ka kërkuar, do të vazhdojë të paktën 10 vite. Kjo gjë nuk  
25 mund të jetë në interesat e drejtësisë.

1 Ajo minon shumë të drejtën ndërkombëtare penale, minon  
2 gjithçka të mirë që kjo Gjykatë po përpiqet që të bëjë. Mohon  
3 drejtësinë për të akuzuarit si dhe drejtësinë për viktimat dhe  
4 drejtësinë për dëshmitarët. Është një fatkeqësi e madhe, do të  
5 thosha dhe e bën Gjykatën qesharake, që ta themi siç duhet.

6 Pra, dikush duhet t'i thotë Prokurorisë se si ta  
7 menaxhojë çështjen e saj dhe si ta ulë kohën që kërkon, në një  
8 nivel të menaxhueshëm sepse kjo është një punë që gjykatësit,  
9 Gjykata Ndërkombëtare, e bëjnë gjatë gjithë kohës. Kështu  
10 veprohet. Ndryshe gjyqi nuk është i mundshëm. Në qoftë se ju  
11 nuk bëni diçka, do të jetë, mendoj, tribunali i fundit  
12 ndërkombëtar që vepron në këtë mënyrë, që ngrihet dhe vepron  
13 kështu.

14 Për sa na takon neve, ne kemi filluar procesin duke u  
15 përpjekur të shikojmë se ç'mund të bëjmë. Por gjithmonë kini  
16 parasysh që asnjë nga dëshmitarët nuk do të bëjë akuza të  
17 drejtpërdrejta dhe janë zgjedhur shkel e shko për të folur për  
18 krime konkrete që nuk kanë lidhje me të akuzuarit. Siç u tha  
19 edhe më përpara, është ndjekur pikëpamja nga TPNJ në të gjitha  
20 çështjet që kishin të bënin me Kosovën dhe në aktgjykimet dhe  
21 nga ambasadori e shumë njerëzve të tjerë që janë të angazhuar  
22 thellësisht me Kosovën, krimet që janë kryer nuk ishin fare  
23 ndonjë kontroll qendror nga askush. Thjesht ka qenë produkti i  
24 një situate ku ligji mungonte dhe ku armët ishin sheshit.

25 Pra, duke pasur parasysh krimet e kryera në të gjithë

1 Kosovën nga serbët dhe ku popullsia është shqiptare, është  
2 spastruar nga Kosova. Pak a shumë ky ka qenë konteksti mbi të  
3 cilin mbështeten këto akuzat. Ne e dimë se çfarë përpiqen të  
4 arrijnë këto akuza, por Prokuroria nuk duhet të mos marrë  
5 parasysh kohëzgjatjen e gjyqit. Në fund të ditës, çështja  
6 shtrohet -- ne shikojmë dënimet që janë dhënë për  
7 konspiratorët serbë që vetë kishin urdhëruar vrasjet e mijëra  
8 e mijëra shqiptarëve të Kosovës dhe përzënien e popullsisë së  
9 mbetur nga Kosova, shkatërrimin e shtëpive, bagëtime, gjësë së  
10 gjallë dhe kemi parë heqjen e targave të makinave të tyre,  
11 marrjen e dokumenteve, këto janë të gjithë krime të kryera  
12 kundër njerëzimit në atë periudhë dhe dënimet që ju dhanë  
13 këtyre personave ndryshonin nga 10 vite deri në 15, pak a  
14 shumë.

15 Pra, në thelb, në qoftë se nuk ndërhyjni dhe veproni,  
16 besoj që s'do më kundërshtoni sepse mund të them se i keni  
17 dhënë shumë dorë të lirë Prokurorisë. Prandaj jemi këtu ku  
18 jemi. Nuk e keni ndihmuar Prokurorinë ta menaxhojë si duhet  
19 kohën dhe të mos e lejoni të bëjnë atë që bëjnë, duke i  
20 shkelur rregullat.

21 Ky është rasti për të bërë diçka për këtë situatë. Ju nuk  
22 mund ta dërgoni si duhet në Trupin Gjykses që mendohet të  
23 zgjasë 10 vite. Pra duhet të vendosim se cila do të ishte  
24 procedura e duhur për zgjidhjen e kësaj çështjeje. Do të  
25 dërgoni një çështje të vazhdojë 10 vite para Trupit Gjykses

1 apo do të bëni diçka tani?

2 Me kënaqësi -- nuk po sugjeroj që të merrni vendim tani,  
3 sigurisht, për këtë, në bazë të parashtrimeve me gojë, por nuk  
4 duhet të harxhoj kohë parashtrimi me gojë që të marr  
5 përgjigjen -- që të më thoni që "Nuk vlej".

6 Pra mendoj që është pjesë e funksioneve tuaja që  
7 Prokurorisë t'i vendosni një kufi lidhur me kohën, vëllimin,  
8 numrin e dëshmitarëve, kategoritë e çështjeve dhe mënyrën se  
9 si ata do ta paraqesin çështjen. Se në qoftë se nuk e pranoni  
10 që keni këtë juridiksion, unë do të thosha që nuk është e  
11 vërtetë. Pra do të doja që ju të ndiqni këtë rrugë. Nëse  
12 mendoni se keni juridiksion për të vendosur kufi në numrin e  
13 dëshmitarëve dhe numrin e orëve, Prokuroria ka të drejtë të  
14 pretendojë qëllimet e paraqitjes së çështjes së saj në gjyq.

15 Pra është një situatë e jashtëzakonshme ku ndodhemi, ku  
16 Prokuroria i ka thyer të gjitha rregullat, të gjitha afatet  
17 dhe ka gënjyer gjykatën për atë që do të ndodhë, për sa i  
18 takon kohëzgjatjes së fazës paraprake, duke e fryrë  
19 kundërshtimin e saj ndaj fakteve të njohura. Pse duhet z.  
20 Veseli të paraqitet në gjyq. Në fund të ditës, do të shërbejë  
21 10 vite në burg, sepse ai -- në qoftë se do të dënohej, mund  
22 të dënohej duke qenë i lirë.

23 Prandaj ju ftoj që të pranoni përgjegjësitë e vërteta që  
24 keni për të vendosur një farë urdhri në këtë çështje. Në qoftë  
25 se nuk e bëni këtë, atëherë është përgjegjësia juaj që situata

1 është plotësisht jashtë kontrollit.

2 Prandaj ju lutem a mund të na jepni një indikacion se si  
3 mendoni se duhet trajtuar kjo çështje?

4 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Emerson.  
5 Unë nuk do të jap asnjë vendim sot, sidomos në këtë kategori  
6 "për punët e tjera". Sepse është një çështje shumë serioze. Ka  
7 mënyra të ndryshme për të siguruar efektivitetin e  
8 procedurave. Të gjithë duhet të marrim përgjegjësitë e tyre  
9 për këtë gjë, por kjo nuk mund të jepet tani, në një  
10 konferencë për ecurinë e çështjes. Janë çështje që padyshim do  
11 të trajtohen dhe rritja e efektivitetit të procedurave është  
12 një pjesë pa dyshim e rëndësishme e funksionit tonë.

13 PËRKTHYESJA: Folësit flasin njëri mbi tjetrin dhe nuk  
14 kuptohen.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Do të flas për një çështje  
16 për rendin e ditës, mund të prisni?

17 Z. Young?

18 Z. YOUNG: [Përkthim] Asgjë s'kam për të shtuar.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Znj. Alagendra?

20 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Nuk kam gjë për të shtuar.

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Laws, doni të shtoni  
22 diçka?

23 Z. LAWS: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Jo, asgjë.

24 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Prokuror, keni fjalën.

25 ZNJ. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Shumë shkurt lidhur me

1 rendin procedural. E kam konstatuar që më parë që ndonjëherë  
2 gjendemi në situata kur ekipet e Mbrojtjes bëjnë akuza që sa  
3 venë e bëhen edhe më të pavërteta. Por pastaj na ikën koha,  
4 ose siç jemi tani në fund pothuajse dhe na kërkohet të  
5 përgjigjemi me shpejtësi. Dua që të jemi në një situatë që,  
6 kur na duhet të dëgjojmë akuza të tilla, që s'lidhen me temën,  
7 që vazhdojnë gjithnjë e më shumë dhe që janë krejtësisht të  
8 palidhura me çështjen, duhet të na jepet koha e mjaftueshme  
9 për t'u përgjigjur, sepse ne jemi -- nuk është kjo mënyra për  
10 të menaxhuar një Konferencë për Ecurinë e Çështjes duke mos na  
11 lënë kohë për të diskutuar.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Prokuror.

13 I paralajmëroj palët ta thonë paraprakisht nëse duan të  
14 përmendin çështje të veçanta dhe çështja e efikasitetit të  
15 procedurave do të trajtohet në vendime me shkrim. Ka të  
16 drejta, kompetenca që ka gjykatësi i procedurës paraprake  
17 lidhur me këto çështje.

18 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Dua të përgjigjem për themelin e  
19 çështjes. Do të thosha se krahasime thjesht matematikore, siç  
20 janë paraqitur nga Mbrojtja e Veselit në parashtrimin me  
21 shkrim dhe sot përsëri, na hyjnë shumë pak në punë.

22 Mbrojtja përmendi disa çështje konkrete si shembuj, njëra  
23 ishte ajo e Shainoviçit. Edhe një vështrim i sipërfaqshëm i  
24 kalendarit të gjyqit tregon se që nga korriku i vitit 2006  
25 deri në qershor të vitit 2007, ishin dhjetë muaj gjatë të

1 cilëve Prokuroria paraqiti çështjen dhe pastaj katër muaj të  
2 tërë nuk u mbajtën seanca dhe në vitin 2007 vetëm tre muaj.  
3 Pra nga dhjetë muaj, Gjykata nuk u mbledh në seancë. Duhet  
4 bërë shumë kujdes kur bëhen ekstrapolime të tilla. Për sa i  
5 takon TPNJ-së në përgjithësi, dhoma të ndryshme gjyqësore  
6 ndoqën qasje të ndryshme por parashtrimi se në përgjithësi  
7 asnjë dëshmitar nuk zgjaste më shumë se gjysmë ore nuk është  
8 një pasqyrim i saktë i praktikës së kësaj gjykate. Lidhur me  
9 këtë çështje, fushëveprimi i provave dhe mënyra e paraqitjes  
10 janë gjëra të cilat Trupi Gjyqësor do t'i trajtojë në momentin  
11 e duhur në përputhje me rregullën 117 dhe 118. Megjithatë, më  
12 lejoni të jem e qartë, ZPS-ja do të paraqesë prova efikase.  
13 Duhet të balancojmë faktet me barrën e provës, me interesin e  
14 viktimave dhe të dëshmitarëve. Këtë do ta bëjmë në një mënyrë  
15 të balancuar, efikase, siç kemi bërë dhe në çështje të tjera  
16 përpara kësaj Gjykate deri më tani. Dhe pa dyshim nuk bëhet  
17 fjalë për vite të tëra, siç u paraqit nga Mbrojtja e Veselit.

18 Por ajo që ka më rëndësi, Gjërat këtu po renditen në  
19 mënyrën e gabuar. ZPS-ja nuk është në gjendje të vlerësojë  
20 mënyra se si të bëhet gjyqi më efikas, pa i ditur ato gjëra,  
21 të cilat mbrojtja i pranon apo i kundërshton. Ne kemi dhënë  
22 faktet për të cilat ramë dakord në mars të vitit 2021, një vit  
23 më parë dhe nga parashtrimet me shkrim kuptojmë që ekipet e  
24 Mbrojtjes janë duke i shqyrtuar këto dhe ne me kënaqësi do të  
25 pranonim t'i diskutonim.

1 Po ashtu, nëse ekipet e Mbrojtjes duan të paraqesin dosje  
2 paraprake, duam t'i shqyrtojmë me kujdes. Shpresojmë që  
3 informacioni i rëndësishëm do të jetë i disponueshëm për  
4 Trupin Gjykses për të marrë vendimet sipas Rregullës 118.

5 Së fundi, kjo nuk është koha apo vendi për të diskutuar  
6 themelin e çështjes. Kjo do të përcaktohet në gjyq përpara  
7 Trupit Gjykses. Megjithatë, në kundërshtim me parashtrimet e  
8 Mbrojtjes së Veselit, provat e nxjerra të përmbledhura në  
9 dosjen paraprake, janë qartë të lidhura me përgjegjësinë e  
10 katër të akuzuarve për krimet e akuzuara. Ajo përfshin  
11 deklarata të asaj kohe, të synimit dhe njohurive, si me shkrim  
12 dhe me gojë, përfshin prova të qarta të kontributit dhe  
13 pjesëmarrjes së z. Veseli, dhe veçanërisht lidhur me provat e  
14 mënyrës shumë qendrore të përfshirjes të organeve drejtuese.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

16 Nuk shoh ndonjë kërkesë.

17 Z. KEHOE: [Përkthim] Një koment shumë të shkurtër lidhur  
18 me efektivitetin dhe thirrjen për faktet e rëna dakord.

19 Më lejoni të kujtoj Prokurorinë se 106 dëshmitarë janë  
20 anonimë. 106 dëshmitarë *vivavoce* nuk janë të njohur për ne.  
21 Një pyetje retorike kam: a mendon Prokuroria se kjo ja bën të  
22 vështirë Mbrojtjes të vlerësojë faktet e rëna dakord? Çfarë  
23 mendojnë ata?

24 Sigurisht me kemi një aktakuzë të redaktuar lidhur me  
25 ngjarje, njerëz dhe ne nuk i diskutojmë dot me klientin tim.



1 Është një propozim absurd, me gjithë respektin e duhur për të  
2 thënë që jemi gati për këtë gjyq, i kemi nxjerrë faktet dhe  
3 barra është e Mbrojtjes. Duke pasur parasysh ato që ata na  
4 kanë dhënë deri tani.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Kehoe.

6 Nuk shoh ndonjë kërkesë për të marrë fjalën dhe këtu  
7 përfundon seanca e sotme.

8 Faleminderit palëve, pjesëmarrësit për praninë e tyre,  
9 dhe si gjithmonë falënderoj përkthyesit, stenografët, teknikët  
10 dhe personelin e sigurisë për ndihmën e tyre.

11 Dhe do të takohemi përsëri në 24 mars dhe do t'ju  
12 informoj nëse do të mbledhemi për seancën në 22 shkurt, pasi  
13 të marr parashtrimet me shkrim të të gjitha palëve.

14 Këtu përfundon seanca e sotme.

15 --- Seanca mbyllet në orën 17.42.

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25